



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 501 Akti

Nr. 667 Vendimi
Tiranë, më 26.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bektashi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 24.5.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Lazër Sallaku**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 19.6.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Lazër Sallaku, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 22.7.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 3.5.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 18.5.2023 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 e 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Po në datën 3.5.2023, subjekti i rivlerësimit: (i) u njoftua lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) u njoftua me kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) u njoftua të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 15 ditëve. Në datën 18.5.2023, subjekti dërgoi në mënyrë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 19.5.2023, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 19.5.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 24.5.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si

dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Lazër Sallaku. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 24.5.2023 për të rifilluar më 26.5.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Lazër Sallaku ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar nr. *** prot., datë 28.9.2018, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ku më parë subjekti, në datën 24.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për

¹ Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament me nr. pasurie *, i ndodhur në S, Tiranë**, regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe fizike 86.30 m², sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, datë 8.11.2016. Paguar kësti i parë 10.000 euro për rezervim në datën 6.2.2014; kësti i dytë 20.727 euro paguar me nënshkrimin e kontratës në datën 24.12.2014, marrëveshje e lidhur me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014; kësti i tretë 15.596 euro paguar në datën 9.6.2016 dhe lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016. Burimi i të ardhurave: të ardhura nga paga, të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese, dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj. Pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj. Vlera: 46.322 euro. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkangjitur deklaratës disa dokumente².

² Certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar në datën 8.11.2016, për pasurinë nr. ***, të ndodhur në Selitë, Tiranë, me sip. 86.3 m², në zotërim në pjesë të barabartë nga subjekti dhe znj. A.S.S; kopje karteletë pasurisë, lëshuar në datën 8.11.2016, me vlerë blerjeje 46.322 euro; kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016, për blerjen e apartamentit me nr. ***, ndodhur në S, Tiranë, me sip. 86.3 m², në vlerën 46.322 euro, me palë shitëse "A" sh.p.k. dhe palë blerëse A.S (S) e Lazër Sallaku. Çmimi për blerjen e kësaj pasurie është likuiduar nga blerësi në ekzekutim të detyrimeve të kontratës për ndërtim apartamenti me nr. ***, datë 15.12.2014; kopje kartash identiteti të palëve; ekstrakt i regjistrimit të shoqërisë ndërtuese me NIPT ***; certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar në datën 10.6.2015, në pronësi të firmës ndërtuese "A" sh.p.k.; dy kopje karteletë në pronësi të firmës ndërtuese; plan rievimi i sipërfaqes 86.3 m² të apartamentit; kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep. nr. *** kol., datë 15.12.2014, për blerjen e apartamentit me nr. ***, me sipërfaqe totale 100.7 m², ku përfshihet edhe sipërfaqja e përbashkët, në vlerën 46.322 euro. Pagesa do të kryhet e ndarë në tri këste, ku kësti i parë në shumën 10.000 euro është parapaguar nga porositësit A.S dhe Lazër Sallaku në datën 6.2.2014, kësti i dytë në shumën 20.727 euro do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe kësti i tretë në shumën 15.595 euro do të paguhet deri në datën 30.8.2015; nxjerrje llogarie nga "Raiffeisen Bank" e llogarisë në emër të shoqërisë "A", ku është kryer transaksioni bankar në datën 6.2.2014, në shumën 10.000 euro,

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ZVRPP-së Tiranë, DPPP*. Rezulton se pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit Lazër Sallaku. Gjithashtu rezulton që subjekti të ketë marrë një kredi në UBA Bank, në datën 15.11.2017, në shumën 36.000 euro, me qëllim kompensim për pjesëtim pasurie bashkëshortore, blerje e pjesës takuese të ish-bashkëshortes/bashkëjetueses A.S, në apartamentin e deklaruar, duke e vendosur si garanci hipotekore.

Hetimi i Komisionit

17.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, me përshkrimin “Pakësim i gjendjes *cash* nga pagimi i dy kësteve për shoqërinë “A” sh.p.k. për ndërtimin e një apartamenti me adresë Komuna F, rezidenca “****”, në objektin ***, Rruga ***, apartamenti nr****, me sipërfaqe ndërtimore 100.7 m², përfshirë sipërfaqen e përbashkët, 2+1. Kësti i parë 10.000 euro parapaguar për rezervim në datën 6.2.2014 dhe kësti i dytë 20.727 euro paguar me nënshkrimin e kontratës në datën 24.12.2014, marrëveshje e lidhur me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014. Burimi i krijimit: nga gjendja *cash*”. Vlera: 30.727 euro.

17.3 Ndërsa në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Pakësim i gjendjes cash me pagimin e kështit të tretë 15.596 euro, paguar në datën 9.6.2016 dhe lidhur kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016, për apartament me nr. ***, ndodhur në S, Tiranë, regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në zonën kadastrale ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe fizike 86.3 m², sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP Tiranë, lëshuar në datën 8.11.2016. Burimi i krijimit: (i) nga gjendja cash e kursyer nga të ardhurat nga paga; (ii) të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; (iii) dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; (iv) pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetueses nga babai i saj”.*

17.4 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar³ në lidhje me këtë pasuri, konstatohet se ajo konfirmohet e regjistruar në ASHK në emër të z. Lazër Sallaku, me të dhënat: *pasuria e llojit apartament nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 86.3 m²*.

17.5 ZQRPP-ja⁴, me *email*-in datë 24.8.2018, konfirmon se nga riverifikimi në sistemin digjital dhe dokumentacionin që disponon kjo zyrë u konstatua se në emër të subjektit Lazër Sallaku figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 86.3m², në z. k. ***, vol. ***, f. ***. Kjo zyrë ka bashkëlidhur:

- i) kartelën e pasurisë për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 86.30 m² në pronësi të z. Lazër Sallaku (D.NOT.***, datë 22.11.2017, NOT N.GJ). Në seksionin E (hipotekat, vendimet e gjykatës, kufizime) rezulton shënimi “Bllokohet pasuria në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë për shumën 36.000 euro”, K.HIP nr. ***, datë 15.11.2017;

nga A.S, për llogari të shoqërisë ndërtuese; transaksion bankar në bankën “Credit Agricole Albania”, nr. ***, datë 24.12.2014, në shumën 20.725 euro, nga A.S për llogari të shoqërisë ndërtuese; transaksion bankar në “Raiffeisen Bank”, nr. ***, datë 9.6.2016, në shumën 15.596 euro, nga A.S për llogari të shoqërisë ndërtuese; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2013, nga M.A, e cila i dhuron shumën 40.000 euro vajzës së saj A.S me rastin e martesës; mandatpagesë datë 12.2.2004, e “Alpha Bank” për tërheqjen nga M.S të shumën 46.200 euro nga llogaria e saj në këtë bankë, me nr. ***. Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së; dëshmi trashëgimie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2013, me të cilën bashkëjetuesja e subjektit ka fituar të drejtën e trashëgimisë si trashëgimtare ligjor me ½ pjesë të trashëgimlënësit S.S; kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme (me rezervë, me kusht) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2014, për blerjen e apartamentin me nr. ***, ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 57.6 m², në vlerën 32.000 euro (palë shitëse E.S e A.S dhe palë blerëse E.M e V.M); kopje kartelesh lëshuar më 14.7.2014 në pronësi të A dhe A.S (S), në bashkëpronësi me pjesë të barabartë; hartë treguese e regjistrimit të pronës; transaksion bankar datë 8.8.2014, në vlerën 32.000 euro, për pagesën totale të apartamentit nga E.M tek A dhe E.S; transaksion bankar datë 29.8.2014, nga NBG Bank, nga A.S, në shumën 16.000 euro, me përshkrimin “Tërheqje nga shitja e apartamentit (mbajtës të llogarisë A.S dhe E.S)”. Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

³ Referuar informacionit të dhënë nga ASHK/Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1 me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴ Aneks nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

ii) kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016, për blerjen e apartamentin nr. ***, ndodhur në Selitë, Tiranë, me sip. 86.3 m², në vlerën 46.322 euro, me palë shitëse “A” sh.p.k. dhe palë blerëse A.S (S) e Lazër Sallaku. Çmimi për blerjen e kësaj pasurie është likuiduar nga blerësi në ekzekutim të detyrimeve të kontratës për ndërtim apartamenti, nr. ***, datë 15.12.2014;

iii) pjesë të kontratës së hipotekës datë 15.11.2017, me Bankën e Bashkuar të Shqipërisë.

17.6 UKT-ja⁵ informon se në emër të z. Lazër L. Sallaku rezulton kontrata nr. ***, për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve familjarë. UKT-ja ka depozituar edhe kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016.

17.7 FSHU-ja⁶ informon se me gjeneralitetet Lazër L. Sallaku, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Tiranë.

17.8 Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, nga hetimi rezultuan faktet e mëposhtme:

17.8.1 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar⁷ së bashku me deklaratën *Vetting* kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014, me palë sipërmarrëse shoqërinë “A” sh.p.k. dhe palë porositëse A.S dhe Lazër Sallaku. Objekt i kësaj kontrate ka qenë porositja e apartamentit nr. ***, me sip. 100.7 m², me adresë Komuna F, rezidenca “****”, në objektin ***, Rruga ***. Vlera totale e porosisë së apartamentit është 46.322 euro, vlerë e cila do të likuidohet në mënyrë periodike, specifikisht: kësti i parë 10.000 euro parapaguar nga porositësit në datën 6.2.2014 për rezervimin; kësti i dytë 20.727 euro me nënshkrimin e kontratës; kësti i fundit 15.595 euro deri më 30.8.2015.

17.8.2

17.8.2 Nga hetimi rezultoi se likuidimi i pasurisë është kryer sipas të dhënave të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1

Data	Shuma e paguar (euro)	Përshkrimi
6.2.2014	10,000	A.S derdh këst apartamenti në llogarinë bankare të “A” sh.p.k. në “Raiffeisen Bank”
24.12.2014	20,725	Kalim nga A.S te “A sh.p.k. për blerje apartamenti sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014 (transferim fondesh i brendshëm në bankën “Credit Agricole”)
9.6.2016	15,595	A.S depoziton në llogarinë bankare të “A” sh.p.k. në “Raiffeisen Bank”, likuidim këst i fundit blerje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014

17.8.3 Komisioni konstatoi se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, pasuria është regjistruar në emër të Lazër Sallaku dhe A.S, ndërsa në dokumentacionin e depozituar nga ASHK dhe ZRPP, pasuria rezulton e regjistruar vetëm në emër të subjektit. Ky ndryshim i pronësisë vjen për shkak të divorcit⁸ dhe dakordësisë së shprehur në marrëveshjen⁹ e pjesëtimit të pasurisë. Sipas marrëveshjes së divorcit është dakordësuar mes palëve që pasuria apartament + garazh

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2020.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.9.2020.

⁷ Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸ Vendim nr. ***, datë 30.6.2015, depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 22.7.2020.

⁹ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2017.

të kalojë në emër të subjektit të rivlerësimit, me kushtin që ai do të duhet t'i paguajë ish-bashkëshortes A.S shumën 45.000 euro.

17.8.4 Në DPV-në e vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesën e shumës 45.000 euro, sipas marrëveshjes për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror pas zgjidhjes së martesës, me burim krijimi hua 11.000 euro¹⁰ dhe kredi në shumën 36.000 euro nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

17.8.4.i Në lidhje me burimin e krijimit të shumës së marrë hua prej 11.000 euro, subjekti, pasi është pyetur¹¹, ka deklaruar se djali i tezes së tij, z. E.D, ka pasur dhe ka të trashëguara nga babai biznese dhe pasuri të paluajtshme, të cilat edhe i ka shitur. Subjekti, për të provuar këtë fakt, ka depozituar kontratë premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2017, për apartament banimi, lidhur para noterit A.S, kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2020, si dhe certifikatën për vërtetim pronësie.

17.8.4.ii Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, i rezultoi se z. E.D është njëri prej 4 bashkëpronarëve përfitues në pasurinë nr. ***, me sip. 105.7 m², të cilën e kanë shitur me kontratë premtim shitjeje datë 24.10.2017 dhe më tej këtë shitje e kanë finalizuar me kontratën e shitjes datë 16.10.2020 tek shtetasi A.H, për shumën 8.000.000 lekë. Në përmbajtje të kontratës së premtim shitjes parashikohet se pala shitëse është likuiduar përpara nënshkrimit të kontratës me shumën e dakordësuar për shitjen e pasurisë, pra përpara datës 24.10.2017 (ndërsa huaja është dhënë më 23.10.2017). Duke qenë se njëri prej bashkëpronarëve është huadhënësi për subjektin e rivlerësimit, në raport edhe me numrin e bashkëpronarëve në këtë pasuri, pjesën takuese të saj edhe në vlerën e shitjes, Komisioni konstatoi se ai ka pasur në dispozicion shumën 11.000 euro për ta dhënë hua tek subjekti i rivlerësimit. Mbi këto fakte, trupi gjykues çmoi se huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

17.8.4.iii Ndërsa lidhur me kredinë në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, nga korrespondenca e Komisionit me UBA Bank¹², kjo e fundit informon se z. Lazër L. Sallaku është financuar në shumën 36.000 euro, datë 20.11.2017, me afat 180 muaj dhe me normë interesi vjetore 4.5%. Nga analizimi i *statement*-it konstatohet se në datën e disbursimit vlera 35.000 euro është transferuar në llogarinë e noterit publik N.GJ, person fizik, sipas marrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2017. Noteri publik, në datën 22.11.2017, ka transferuar të gjithë shumën prej 45.000 euro¹³ në llogarinë bankare të znj. A.S në "Raiffeisen Bank", me përshkrimin "Pagesë sipas ndarje pasurie dhe regjimi pasuror për zgjidhjen e martesës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2017". Në këto rrethana, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë burim, shërbyer për kthimin e pagesës së shumës 45.000 euro, sipas marrëveshjes për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror pas zgjidhjes së martesës.

17.9 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

17.9.1 Rezulton se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer: të ardhurat nga paga; të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese, dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj.

17.9.2 Komisioni hetoi për secilën nga burimet e krijimit dhe i ka analizuar ato, sikurse referohet në vijim:

¹⁰ Marrë shtetasit E.D (djali i tezes) me kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2017.

¹¹ Me pyetësorin nr. 2, datë 27.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹² Shkresë ref. ***, datë 10.9.2020.

¹³ 11.000 euro janë paguar nga subjekti në llogarinë e noterit publik pas nënshkrimit të marrëveshjes për ndarje pasurie dhe 35.000 euro, datë 20.11.2017, ditën e disbursimit të kredisë nga UBA Bank.

17.9.2.i Nga hetimi i kryer sa i përket të ardhurave nga paga të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes, rezultoi se ata kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore dhe të ardhurat e tyre janë konfirmuar që përmbushin kërkesat e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

17.9.2.ii Lidhur me dhuratën e bërë ndaj ish-bashkëshortes nga nëna e saj, në shumën 40.000 euro, rezulton se:

a. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhuratën në shumën 40.000 euro në DPV-në e vitit 2012, me përshkrimin “Dhuruar bashkëshortes nga nëna e saj me rastin e martesës (datë 5.6.2012), vlera 40.000 euro”.

b. Subjekti ka depozituar¹⁴ deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2013, ku deklarohet nga nëna e ish-bashkëshortes, shtetasja M.A, se *shtetasen A.S e ka vajzë dhe me rastin e martesës së saj i ka dhuruar një shumë prej 40.000 euro. Këtë shumë ia ka bërë dhuratë dhe se kjo është dhuratë e parevokueshme.*

c. Në procesverbalin e mbajtur më 14.10.2014, në ILDKPKI¹⁵, subjekti ka deklaruar për burimin e shumës 40.000 euro se: *“Në dijeninë time, burimi i kësaj shume janë nga pjesa e dhënë nga vëllezërit e saj nga pronat të cilat i kanë pasur në qytetin e Durrësit. Po ju paraqes një mandatpagesë të “Alpha Bank”, datë 12.2.2004, në të cilën saktësohet tërheqja e bërë nga M.S (nëna e bashkëshortes) e shumës prej 46.200 euro. Nuk disponon dokumentacion lidhur me pasuritë e shitura në Durrës”.*

ç. Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës së dhuruar dhe njëkohësisht i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues. Subjekti¹⁶ në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se kjo shumë është dhuruar nga nëna e ish-bashkëshortes së tij, e cila e ka disponuar atë shumë kohë përpara martesës me vajzën e saj dhe shumë kohë përpara se subjekti të kishte lidhje me të. Subjekti ka sqaruar¹⁷ se *nuk ka komunikim me ish-bashkëshorten e tij, ajo ka krijuar një familje tjetër; ka konfirmuar se ajo jeton në Itali, atje ku edhe nëna e saj ka ndërruar jetë. Ai ka vendosur në dispozicion të Komisionit numrin personal të ID-së së të ndjerës, me qëllim kryerjen e verifikimeve. Subjekti ka depozituar edhe një herë kopje të mandatpagesës, të cilën e ka depozituar më parë edhe me deklaratën *Vetting*, duke theksuar në vijim se shuma është tërhequr nga nëna e ish-bashkëshortes dhe se ky mandat provon edhe burimin e ligjshëm të shumës.*

d. Nga aksesit i Komisionit në sistemin multifunksional deri aktualisht nuk konfirmohet pasuri e paluajtshme në emër të shtetasës M.A.

dh. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti si në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2014¹⁸, edhe gjatë hetimit administrativ, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar prej 40.000 euro, është i pamjaftueshëm dhe, në këto kushte, duket se nuk provohet burimi i krijimit.

e. Deri në fazën e hetimit, Komisioni konstatoi faktet e mëposhtme:

i) Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2014, ka deklaruar në ILDKPKI se si burim i shumës së dhuruar 40.000 euro ish-bashkëshortes së tij A.S¹⁹ nga nëna e saj, në dijeninë e tij është *nga pjesa e dhënë nga vëllezërit e saj nga pronat të cilat i kanë pasur në qytetin e Durrësit.*

ii) Nga korrespondenca me FSHU-në²⁰ konfirmohet se nëna e ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. M.A, në datën 15.10.2007 ka hapur një kontratë shërbimi me energji elektrike, çka

¹⁴ Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁵ Depozituar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020.

¹⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 27.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Pyetësor nr. 3, datë 19.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Kohë kur subjekti ishte i martuar.

¹⁹ E cila rezultoi e divorcuar në vitin 2005 dhe njëkohësisht figuron me mbiemrin A. për shkak të ndryshimit të mbiemrit nga S. në A.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

minimalisht pasqyron faktin se znj. A/dhuresja e vlerës 40.000 euro pas tërheqjes së shumës 46.200 euro nga “Alpha Bank” duket të ketë pasur investim në pasuri.

iii) Në vitin 2006, znj. A.S ka pasur një martesë tjetër deri në vitin 2010, vit në të cilin edhe është divorcuar.

iv) Znj. A.S ka lidhur martesë ligjore me subjektin e rivlerësimit në vitin 2012 dhe njëkohësisht subjekti në këtë vit ka deklaruar edhe dhurimin nga nëna e saj, në shumën 40.000 euro, shumë e cila është deklaruar se ka shërbyer për blerjen e apartamentit, objekt i këtij hetimi administrativ.

v) Subjekti, për të vërtetuar ekzistencën e shumës së dhuruar 40.000 euro, ka depozituar një mandatpagesë nga “Alpha Bank”, ku pasqyrohet se nëna e shtetasës M.S në vitin 2004 ka tërhequr shumën 46.200 euro.

vi) Në analizë të veprimeve të kryera konstatohet se shuma 40.000 euro është dhuruar pas 8 viteve.

Nga korrespondenca e Komisionit me OTP Bank²¹ (e cila ka përthithur “Alpha Bank”), rezultoi se shtetasja M.XH.S (A) në datën 10.2.2004 ka përfituar me dy transferta shumën 86.200 euro (26.200 euro dhe 60.000 euro), me përshkrimin “Kalim nga M. M. i L. për blerje apartamenti”. Në vijim, rezulton se znj. S. ka tërhequr në datën 12.2.2004 shumën 46.200 euro dhe në muajt në vijim, deri në dhjetor 2004, ka tërhequr edhe pjesën tjetër prej rreth 40.000 euro.

Nga korrespondenca e Komisionit me “ProCredit Bank”²², rezulton se në datën 1.11.2006 shtetasja M.S ka depozituar shumën 3.450.000 lekë, me përshkrimin “Të ardhura nga shitja e shtëpisë”, e cila në këtë datë është transferuar dhe nuk provohej përfituesi i kësaj shume²³. Gjithashtu, pothuajse të njëjtën shumë, në po të njëjtën datë dhe me të njëjtin përshkrim, ka depozituar edhe shtetasi S.S (ish-bashkëshorti i znj. M., e cila rezulton e divorcuar në datën 18.2.2005).

Për të konkluduar nëse znj. A²⁴ përveçse ka përfituar të ardhura, ka shpenzuar ose jo në pasuri, me qëllim evidentimin e mundësisë për të mbajtur të disponueshme shumën 40.000 euro për 8 vite radhazi, Komisioni hetoi mbi disa të dhëna të administruara, të konfirmuara nga RNSH dhe ASHK.

vii) Nga korrespondenca e mbajtur me noterin publik²⁵, konfirmohet se pas tërheqjes së shumës 46.200 euro nga znj. M.A është investuar në blerjen e një pasurie. Më konkretisht, me praktikën noteriale²⁶ u administrua një kontratë noteriale e nënshkruar midis dhurueses (nënës së znj. A.S) M.A dhe shoqërisë ndërtimore “****”, me nr. ****, datë 2.5.2018, sipas së cilës znj. A ka blerë apartamentin me sip. 43 m², me nr. pasurie ****, ndodhur në z. k. ****, sipas certifikatës nr. ****, datë 24.1.2018. Në kontratë, në nenin 3 të saj, cilësohet se blerësi e ka likuiduar totalisht shumën 3.000.000 lekë që në datën 30.12.2005, sikurse vërtetohet edhe nga deklaratat noteriale nr. ****, datë 2.5.2018. Praktika noteriale ka të administruar edhe deklaratën noteriale, ku konfirmohet ky fakt. Po ashtu, praktika ka të administruar edhe planimetrinë, kartelën e pasurisë, certifikatën për vërtetim pasurie të kësaj pasurie, si dhe mandatet e arkëtimit për shlyerjen e pasurisë, të cilat datojnë më 17.11.2006, 27.6.2007 dhe 17.8.2007 dhe pasqyrojnë përkatësisht pagesat e kryera në shumat 20.000 euro, 6.000 euro dhe 500 euro.

²¹ Shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 20.4.2023, nga OTP Bank.

²² Shkresë nr. **** prot., datë 17.9.2020.

²³ “ProCredit Bank”, pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjektiv të rivlerësimit, konfirmoi të dhëna lidhur me përfituesin. Ky konfirmim iu bë me dije edhe subjektivit.

²⁴ Komisioni në kërkimin e tij ka synuar hetim shterues për shtetasen M. edhe me mbiemër A. dhe jo vetëm me mbiemër S..

²⁵ Mbi të dhënat e konfirmuara nga RNSH, administruar në dosjen e Komisionit, noteri publik ka depozituar aktin me shkresën datë 25.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁶ Kthim përgjigjeje shkresës së Komisionit nr. ****, datë 24.4.2023, për noterin publik E.M.

viii) Nga informacioni i përcjellë nga ASHK/Drejtoria Vendore²⁷ rezultoi se në emër të shtetasës M.S nuk figurojnë pasuri në pronësi/bashkëpronësi, tjetërsime nga dhe tek të tretë.

ix) Nga dokumentacioni i administruar nuk u provua ndonjë dhurim nga nëna e znj. S. në adresë të motrës së kësaj të fundit/vajzës tjetër të znj. A, sikurse ishte mundësuar në rastin e znj. A.S.

x) Ligji nr. 84/2016 kërkon provueshmërinë e burimit të ligjshëm të personit tjetër të lidhur, në këtë rast të dhurueses.

ë. Për të gjitha faktet e sipërcituara, Komisioni në përlllogaritjet financiare të kryera nuk e ka përfshirë këtë shumë si të ardhur dhe, për pasojë, analiza financiare e vitit 2012 rezultoi me balancë negative në shumën 4.857.593 lekë.

17.9.2.iii Lidhur me të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshortja bashkëjetuese e subjektit si trashëgimtare ligjore e babait të saj, në shumën 16.000 euro

a. Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar të ardhurat e përfituara në shumën 16.000 euro në DPV-në e vitit 2014, me përshkrimin “Shtuar gjendja *cash* me 16.000 euro, tërhequr më 29.8.2014 nga NBG Bank Albania. Burimi i krijimit: nga shitja e apartamentit me sip. 57.6 m², adresa e pasurisë L, Tiranë, pasuria me nr. ***, me kontratën e shitblerjes për pasuri të paluajtshme, të datës 14.7.2014, me nr. *** rep., nr. *** kol., mbajtur para noterit A.H, i Dhomës së Noterisë Tiranë. Vlera e shitjes 32.000 euro, ku i takon 50% e saj”.

b. Nga dokumentacioni i administruar²⁸ rezultoi se znj. A.S është trashëgimtare ligjore e të ndjerit, babait të saj, sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2013. Për rrjedhojë, ajo dhe motra e saj kanë bërë regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë në hipotekë, nga ku edhe janë pajisur me certifikatën e pronësisë, të cilën më pas e kanë shitur.

c. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se subjekti i rivlerësimit me pyetësorin standard ka depozituar kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme (me rezervë me kusht) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2014, me palë shitëse E.S e A.S dhe palë blerëse E.M e V.M, për pasurinë nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë apartament, me sip. 57.6 m², me adresë në L, Tiranë. Çmimi i pasurisë thuhet se do të jetë 4.500.000 lekë ose 32.000 euro.

ç. I njëjti dokumentacion është administruar edhe nga ASHK-ja, ku, ndër të tjera, edhe formulari i pasqyrës llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë. Sipas këtij formulari, tatimi për t’u paguar ka qenë në vlerën 240.289,92 lekë.

d. Në kushtet kur pasuria përfshin dy bashkëpronarë, sipas dëshmisë së trashëgimisë duket se nuk ngrihen dyshime në lidhje me përfitimin e ½ pjesë takuese të të ardhurave të krijuara nga shitja e saj, pra për shumën 16.000 euro në favor të ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Për sa kohë që pasuria është regjistruar në emër të blerësve, tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie është paguar.

dh. Nga korrespondenca me ABI Bank²⁹, rezultoi se shuma 32.000 euro është ndarë në mënyrë të barabartë mes motrave, konkretisht në datën 29.8.2014 znj. A.S ka transferuar shumën 16.000 euro në llogari të motrës së saj E.S dhe po në këtë datë ka tërhequr *cash* pjesën e mbetur prej 16.000 euro.

e. Komisioni ka përfshirë në analizë ½ e shumës së përfituar nga shitja e pasurisë, si dhe ½ e shumës së shpenzuar për pagesën e tatimit në burim, pra 120.145 lekë.

²⁷ Durrës, Vlorë, Tirana Jug dhe Tirana Veri, me *email*-in e datës 3.5.2023.

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2020, nga ASHK/Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁹ Në rrugë elektronike, me *email*-in datë 27.4.2023.

ë. Meqenëse një pjesë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie janë deklaruar *cash*, Komisioni ka analizuar deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike dhe shumën e akumuluar vit pas viti, e cila është përfshirë në analizën financiare, pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2

Viti	Përshkrimi sipas subjektit në deklaratat periodike	Vlera e deklaruar	Shuma e akumuluar sipas Komisionit
2010	Kursime familjare monetare	500,000	500,000
2011	Kursime familjare monetare	200,000	700,000
2012	Dhuruar bashkëshortes për martesë 40.000 euro	€ 40,000	700,000 lekë dhe 40,000 euro
2013	Nuk ka deklaram		700,000 lekë dhe 40,000 euro
2014	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> nga pagimi i dy kësteve për shoqërinë “A” sh.p.k. për ndërtimin e një apartamenti me adresë Komuna F, rezidenca “****”, në objektin ***, Rruga ***, apartamenti nr. ***, me sipërfaqe ndërtimore 100.7 m ² , përfshirë sipërfaqen e përbashkët, 2+1. Kësti i parë 10.000 euro parapaguar për rezervim më 6.2.2014 dhe kësti i dytë 20.727 euro paguar me nënshkrimin e kontratës, më 24.12.2014, marrëveshje e lidhur me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014. Burimi i krijimit: gjendja <i>cash</i> .	€ 30,727	
	Shtuar gjendja <i>cash</i> me 16.000 euro, tërhequr më 29.8.2014 nga NBG Bank Albania. Burimi i krijimit: shitja e apartamentit me sip. 57.6 m ² , adresa e pasurisë L, Tiranë, pasuria nr. ***, me kontratën e shitblerjes për pasuri të paluajtshme të datës 14.7.2014, me nr. *** rep., nr. *** kol., mbajtur para noterit publik A.H, Dhoma e Noterisë Tiranë. Vlera e shitjes 32.000 euro, ku i takon 50% e saj.	€ 16,000	
	Shtuar gjendja <i>cash</i> me 1.000 euro. Burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “Ford Fiesta” ³⁰ , me kontratën e shitjes datë 6.11.2014, me nr. *** rep., nr.*** kol., para noterit publik M.B, Dhoma e Noterisë Tiranë.	€ 1,000	
	Pakësuar gjendja <i>cash</i> me 7.000 euro pasi është blerë automjeti tip “Daimler Chrysler” sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2014, mbajtur nga noteri publik SH.GJ, Dhoma e Noterisë Tiranë.	€ 7,000	700,000 lekë dhe 19,273 euro
2015	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> me 200.000 lekë pasi është blerë automjeti tip “Volkswagen” sipas kontratës së shitblerjes së automjetit me nr. *** rep., nr.*** kol., datë 24.9.2015, mbajtur nga noteri publik I.H, Dhoma e Noterisë Sh. Burimi i krijimit: gjendja <i>cash</i> .	200,000	500,000 lekë dhe 19,273 euro

³⁰ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 27.3.2023, subjekti ka deklaruar se automjeti tip “Ford Fiesta” është blerë nga bashkëshortja e tij A.S para se të njihej me të dhe se nuk disponon kontratën e shitblerjes, por nga ana e saj i është thënë se e ka blerë 3.000 euro, të dhëna nga babai i saj, i ndjeri S.S, me rastin e mbarimit të shkollës së lartë. Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes që ka disponuar, me nr. ***rep., nr. *** kol., datë 6.11.2014, para noterit publik M.B, Dhoma e Noterisë Tiranë, nga ku rezulton se automjeti është shitur në vlerën 1.000 euro.

2016	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> me pagimin e këstit të tretë 15.596 euro, paguar më 9.6.2016 dhe lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016, për apartamentin me nr. ***, ndodhur në S, Tiranë, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe fizike 86.3 m ² , sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 8.11.2016 nga ZVRPP-ja Tiranë Burimi i krijimit: i) gjendja <i>cash</i> e kursyer nga të ardhurat nga paga ii) të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese iii) dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj iv) pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj	€ 15,596	
	Pakësuar gjendja <i>cash</i> me pagimin e 7.547 euro, parapaguar më 13.10.2016 me kontratën premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2016 dhe garazh nr. ***, me sip. 22.9 m ² , në kompleksin rezidencial “****”, S, Njësia Administrative F, Tiranë, me nr. pasurie ***, regjistruar në z. k. ***, vol. ***, f. ***. Burimi i krijimit: i) gjendja <i>cash</i> e kursyer nga të ardhurat nga paga ii) të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese iii) dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj iv) pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetueses nga babai i saj	€ 7,547	

f. Si rezultat i këtyre deklarimeve në lidhje me kursimet *cash*, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet³¹ për vitet 2010 – 2016³², ku si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të shumës 40.000 euro, dhuruar bashkëshortes, pasi nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit, Komisioni konstatoi se: dukej se subjekti i rivlerësimit rezultonte në pamundësi financiare në shumën -4.857.593 lekë në vitin 2012, pasi ai dhe bashkëshortja (në atë kohë) nuk kanë pasur mundësi të kenë gjendje *cash* shumën 40.000 euro, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare; dukej se subjekti i rivlerësimit rezultonte në pamundësi financiare në shumën -167.503 lekë në vitin 2010 dhe në shumën -1.122.332 lekë në vitin 2011 për të krijuar kursimet, si dhe më pas me këto kursime të investojë në pasuritë apartament dhe garazh. Në total, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në një shumë totale prej -6.147.428 lekësh për vitet 2010 – 2012. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e rezultatit, si dhe për të depozituar dokumentacion justifikues në mbështetje të shpjegimeve të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

³¹ Në këtë zë janë përfshirë të gjitha shpenzimet e identifikuar për periudhën 2010 – 2016, specifikisht të detajuara si: shpenzimet e jetesës për vitet 2010 – 2016, sipas shpenzimeve të përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së. Për vitet 2015 – 2016 shpenzimet e jetesës janë përllogaritur për dy persona, ndërsa për vajzën janë përllogaritur sipas vendimit gjyqësor ku detyrimi ushqimor është në vlerën 20.000 lekë/muaj; shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i KPA-së, si dhe deklaratimet e subjektit; shpenzimet e arredimit u bazuan në deklaratimet e subjektit, konkretisht 350.000 lekë për apartamentin e porositur në vitin 2014. Pavarësisht se subjekti deklaroi se këto shpenzime janë kryer në vite, Komisioni ka vlerësuar që për apartamentin e porositur në vitin 2014 ky shpenzim të ndahet në raportin 60% në vitin 2014 dhe 40% në vitin 2015; pagesat e kryera për këstet e kredive janë bazuar në verifikimin e pasqyrave të lëvizjeve bankare. Për kredinë e marrë në vitin 2009 në “Raiffeisen Bank” nga ish-bashkëshortja A.M është përfshirë në analizë likuidimi dhe mbyllja e kësaj kredie në vitin 2011 nga ana e subjektit, sipas parashikimit të marrëveshjes vullnetare; shpenzimet për blerje automjetesh u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin përkatës; shpenzime për detyrimet ushqimore për secilin nga fëmijët e mitur u bazuan në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin përkatës; shpenzimet e qirasë u bazuan në deklaratimet e subjektit, si dhe në dokumentacionin përkatës; shpenzimet për tatimin në burim për të ardhurat e përfituara nga znj. A.S si rezultat i shitjes së pasurisë apartament të përfutur nga çelja e trashëgimisë u bazuan në dokumentacionin përkatës.

³² Referojuni tabelës nr. 4 në materialin e rezultateve të hetimit.

17.10 Në qëndrimin e tij, subjekti ka parashtruar se burimi i ligjshëm i shumës së dhuruar nga personi tjetër i lidhur, si pasuri e vënë para martesës dhe shumë kohë para se ai të njihej me bashkëshorten, nuk duhet të lidhen me procesin e rivlerësimit. Mbi këtë parashtrim subjekti ka referuar vendimin nr. 15, datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke specifikuar paragrafin nr. 25.1 të tij³³, si dhe vendimin nr. 262, datë 17.6.2020 dhe nr. 181, datë 18.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

17.10.1 Subjekti ka shpjeguar se nga “Informacioni i detajuar për transaksionin bankar”, datë 11.5.2023, i “ProCredit Bank”, rezulton se përfitues i transaksionit të realizuar në datën 1.11.2006, në shumën prej 3.450.000 lekësh, ka qenë shtetasja E.S.S, me nr. Llogarie ***, duke provuar kështu se edhe vajza e madhe e së ndjerës, nënës së ish-bashkëshortes, ka marrë një shumë parash nga nëna e saj. Me këtë shumë shtetasja E.S ka blerë me kontratë shitjeje paraprake, datë 17.11.2006, nga shitësi “***”, një apartament në vlerën 26.500 euro dhe 47.000 lekë.

17.10.2 Sipas subjektit, ky apartament i blerë nga e ndjera, nëna e ish-bashkëshortes, nuk është blerë nga shuma 40.000 euro e tërhequr më herët në bankë, duke pretenduar se rrëzohet dyshimi se e ndjera i ka shpenzuar 40.000 euro në blerjen e ndonjë pasurie të paluajtshme dhe se kjo shumë nuk është disponuar prej saj në vitin 2012.

17.10.3 Sipas subjektit, kjo shumë është përdorur nga ish-bashkëshortja për të paguar me këste blerjen e apartamentit, sipas faturave që ka vënë në dispozicion dhe se raporti i tij me këtë pasuri ka qenë si bashkëshort i blerëses gjatë martesës dhe pagesën e një kësti gjatë bashkëjetesës. Në vijim ka shpjeguar se në vitin 2017, kur është ndërprerë bashkëjetesa, subjekti e ka blerë këtë pasuri aq sa ajo e ka blerë, me paratë që ka marrë kredi prej 35.000 euro pikërisht për këtë blerje dhe me një hua prej 10.000 euro marrë një kushëri të tij, sikurse ka deklaruar.

17.10.4 Në vijim, subjekti ka parashtruar një analizë të dispozitave ligjore lidhur me regjimin pasuror të shumës 45.000 euro, sipas nenit 77/b të Kodit të Familjes, i cili parashikon se: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë...”*. Në këtë drejtim, subjekti parashtron se jemi para një pasurie vetjake dhe të ligjshme të ish-bashkëshortes, ish-bashkëjetuese, pasi është dhuruar nga nëna e saj dhe nga trashëgimia ligjore e babait të saj. Ka referuar dispozitat ligjore, e specifikisht nenet 74, 77, 87 dhe 95 të Kodit të Familjes, duke pretenduar se ai nuk dispononte të drejta reale mbi shumën 45.000 euro, pasi e drejta e pronësisë i përkiste vetëm bashkëshortes, si një pasuri vetjake.

17.10.5 Lidhur me diferencat negative në shumën 167.503 lekë të vitit 2010, si dhe në shumën 1.122.332 lekë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit, në qëndrimin e tij të paraqitur në seancë dëgjimore, ka shpjeguar se këto diferenca negative kanë ardhur si rrjedhojë e mosllogaritjes së shumave të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi” në shumën 500.000 lekë, si dhe të mjetit detar, skaf i vogël (sanall), në vlerën 180.000 lekë, në vitin 2009. Sipas subjektit, Komisioni nuk i ka llogaritur si gjendje, pasi nuk janë deklaruar nga ana e tij si të tilla për vitet 2010 e 2011.

17.10.6 Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se ai nuk e ka ditur se kredia konsumatore e marrë nga ish-bashkëshortja A.S (M) në vitin 2009 nuk ishte mbyllur, kur ai ia kishte dhënë paratë e shitjes së dy

³³ Ku arsyetohet se: *“...Në vlerësim të konkluzioneve të mësipërme, Kolegji çmon se këto defekte nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit. Problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit, nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Ndërsa problematikat që lidhen me pasuritë e vëna prej tij apo defektet në deklarimin e saj, të cilat përsëri konsistojnë në një situatë të mbarur nga pasuritë e personit të lidhur, të krijuara para martesë, gjithashtu nuk janë të mjaftueshme e proporcionale me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e këtij kriteri.”*

mjeteve për ta mbyllur atë, duke paraqitur edhe një deklaratë noteriale të ish-bashkëshortes A.M të datës 23.5.2023, e cila konfirmon faktin e deklarimit të tij për këtë situatë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

17.11 Trupi gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

17.11.1 Lidhur me pretendimin e subjektit se burimi i ligjshëm i shumës së dhuruar nga personi tjetër i lidhur si pasuri e vënë para martesës dhe shumë kohë para se ai të njihej me bashkëshorten nuk duhet të lidhen me procesin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se rrethanat mbi të cilat ngrihet ky pretendim i nënshtrohen detyrimit ligjor që kanë subjektet e rivlerësimit, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, në raport me situatën faktike të kësaj çështjeje dhe pasojat që ka passjellë mosprovueshmëria e kësaj të ardhure në procesin e rivlerësimit të tij.

17.11.2 Gjithashtu, në përgjigje të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues arsyeton se neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e ngarkon subjektin e rivlerësimit dhe personin tjetër të lidhur që, në kuadër të marrëdhënies së dhurimit të konfirmuar, të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar që ka shërbyer për krijimin e pasurisë që subjekti ka përfituar.

17.11.3 Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara dhe rrethanave faktike, trupi gjykues çmon pa relevancë referencat e subjektit në vendimet e Kolegjit dhe të Komisionit, si dhe në dispozitat ligjore të Kodit të Familjes, pasi në çështjen objekt vlerësimi, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, hetimi ka evidentuar këto fakte:

17.11.3.i Pasuria apartament është përfituar kur subjekti ka qenë në martesë dhe në detyrë, me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2016, me palë shitëse “A” sh.p.k. dhe palë blerëse subjektin dhe ish-bashkëshorten e tij, ku aktualisht subjekti është pronar i vetëm.

17.11.3.ii Rezulton se subjekti e ka poseduar në mënyrë të vazhdueshme këtë pasuri, duke nisur që prej vitit 2012, sipas deklarimit të tij se ai ka jetuar me qira, në vlerën 200 euro/muaj.

17.11.3.iii Subjekti ka kontribut në këtë pasuri, e cila është derivat i kursimeve bashkëshortore në *cash*, përfshirë edhe dhurimin prej vitit 2012 e deri në vitin 2014 kur janë kryer pagesat, kohë kur subjekti po ashtu ka qenë në detyrë.

17.11.3.iv Është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe, si e tillë, subjekti ka detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të saj.

17.11.4 Përveç sa më sipër, trupi gjykues i ka vlerësuar pretendimet e subjektit duke analizuar situatat faktike të kësaj çështjeje, sikurse do të arsyetohet në vijim, të cilat passollën: (a) mosprovueshmërinë nga ana e subjektit të burimit të ligjshëm; (b) mosidentifikimin e plotë e të qartë të mundësive financiare të dhurueses, që u vlerësuan nga trupi gjykues si rrethana që pamundësuan verifikimin e situatës së vërtetë faktike lidhur me këtë burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi.

17.11.4.i Sa i takon çështjes së mosprovueshmërisë së burimit të ligjshëm, trupi gjykues, bazuar në faktet e dala, ka konstatuar se institucioni i ASHK-së në asnjë rast nuk konfirmoi pasuri në emër e llogari të vjehrrës së subjektit, në çfarëdolloj mënyre fitimi. Ky fakt nuk ndryshoi as përmes qëndrimit të subjektit në funksion të barrës së provës.

17.11.4.ii Pavarësisht qëndrimin të subjektit në seancë dëgjimore se ai është i pamundur të gjejë dokumentacion për shkak të divorcit e rrethanave të tjera, trupi gjykues konstaton se nga ana e subjektit gjatë këtij procesi nuk rezulton asnjë përpjekje për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar. Ky vlerësim nga ana e trupit gjykues bazohet thelbësisht në faktin se subjekti nuk ka bërë asnjë përpjekje të disponojë dokumentacionin e kërkuar në kohën kur ka qenë në martesë dhe bashkëjetonte edhe me vjehrrën e tij, sikurse ka deklaruar. Në këtë drejtim, rezulton se në procesverbalin e mbajtur më 14.10.2014, në ILDKPKI³⁴, subjekti ka deklaruar për burimin e shumës 40.000 euro se: *“Në dijeninë time, burimi i kësaj shume janë nga pjesa e dhënë nga vëllezërit e saj nga pronat të cilat i kanë pasur në qytetin e Durrësit. Po ju paraqes një mandatpagesë të “Alpha Bank”, datë 12.2.2004, në të cilin saktësohet tërheqja e bërë nga M.S (nëna e bashkëshortes) e shumës prej 46.200 euro. Nuk disponon dokumentacion lidhur me pasuritë e shitura në Durrës”*.

17.11.4.iii Ky detyrim i subjektit nuk rezulton të jetë përmbushur as në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, ku, për të udhëzuar subjektet e rivlerësimit në plotësimin e deklaratës, ILDKPKI-ja miratoi udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016”. Referuar pikës 19 të këtij akti, udhëzohej që: *“...nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur në cilësinë e dhuruesit... etj., detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, ...dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit...”*.

17.11.4.iv Trupi gjykues konstaton faktin se në kohën e miratimit të këtij udhëzimi subjekti ka deklaruar se pavarësisht divorcit ai vijonte të bashkëjetonte me shtetasen A.S dhe, në këto rrethana, subjekti ka pasur mundësinë për të pasur informacionin dhe siguruar dokumentacionin e plotë nga bashkëjetuesja, për të provuar burimin e ligjshëm për shumën e dhuruar, në zbatim të këtij udhëzimi.

17.12 Sa i takon çështjes së mosidentifikimit të plotë e të qartë të mundësive financiare të dhurueses, trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe të dhënave të përfituara nga hetimi, vlerëson së vetëm mandati bankar ku vjehrra e tij ka kryer tërheqjen e shumës prej 46.200 euro në vitin 2004, nuk provon ligjshmërinë e shumës, si dhe mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur për shumën e dhuruar pas 8 viteve.

17.12.1 Po ashtu, përfitimi i shumës 86.200 euro nga shtetasja M.XH.S (A) në vitin 2004 me dy transferta (26.200 euro dhe 60.000 euro), me përshkrimin “Kalim nga M. M. i L. për blerje apartamenti”, në raport me fakte të tilla se:

- a) në datën 1.11.2006, shtetasja M.S ka depozituar shumën 3.450.000 lekë, me përshkrimin “Të ardhura nga shitja e shtëpisë”, për të cilën referuar informacionit të detajuar për transaksionin bankar datë 11.5.2023, të “ProCredit Bank”, përfituese në shumën prej 3.450.000,00 lekësh ka qenë shtetasja E. S. S, me nr. llogarie ***, e cila me “Kontratë shitjeje paraprake” të datës 17.11.2006, nga shitësi “****”, ka blerë një apartament në vlerat 26.500 euro dhe 47.000 lekë (këto prova pasqyrojnë faktin se dhuruesja ka shpenzuar një pjesë të këtyre të ardhurave);
- b) të njëjtën shumë, në po të njëjtën datë dhe me të njëjtin përshkrim, ka depozituar edhe shtetasi S.S (ish-bashkëshorti i znj. M), për të cilën përgjatë hetimit nuk u konfirmua ndonjë e dhënë për prejardhjen e këtij transaksioni;
- c) subjekti ka deklaruar pranë ILDKPKI-së se *burimi i shumës së dhuruar është nga pjesa e dhënë nga vëllezërit e saj nga pronat të cilat i kanë pasur në qytetin e Durrësit*, ku përgjatë procesit nga ana e

³⁴ Depozituar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020.

subjektit nuk u paraqit ndonjë e dhënë apo dokument për identifikimin e pronësisë/ve, tjetërsimin e tyre, duke pamundësuar kështu faktin e përcaktimit të pjesës takuese të dhurueses,

– çmohen nga trupi gjykues si rrethana që nuk provojnë mundësinë reale të dhurueses për të mbajtur të disponueshme për 8 vite shumën 40.000 euro, rrethanë kjo e paprovuar dhe e paqartë.

17.13 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve mbi barrën e provës të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësës për shumën 40.000 euro dhe pamundësuar kështu edhe verifikimin e mundësive reale të huadhënës për disponimin e saj për 8 vite.

17.14 Lidhur me balancën negative prej 167.503 lekësh të vitit 2010, si dhe diferencën negative prej 1.122.332 lekësh të vitit 2011, në raport me pretendimet e subjektit, trupi gjykues arsyeton se:

17.14.1 Pretendimi i subjektit se diferencat negative janë rrjedhojë e mosllogaritjes së shumave të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi” në shumën 500.000 lekë, si dhe të mjetit detar, skaf i vogël, në vlerën 180.000 lekë, në vitin 2009, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁵, nuk mund të merren në konsideratë, për sa kohë nuk janë deklaruar nga ana e subjektit si gjendje *cash*³⁶, fakt i pranuar edhe nga ky i fundit në qëndrimin e tij të paraqitur në seancë dëgjimore. Njësia e Shërbimit Ligjor i ka përllogaritur në analizën e kryer të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi” dhe skafit, por nuk janë pasqyruar si gjendje *cash*, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar ato si gjendje *cash*.

17.14.2 Pretendimi i subjektit se ai nuk e ka ditur se kredia konsumatore e marrë nga ish-bashkëshortja në vitin 2009 nuk ishte mbyllur po në këtë vit, nuk qëndron. Në vitin 2009, subjekti ka qenë ende në martesë ligjore me znj. A.S (M) dhe ai ka plotësuar deklaratën periodike në këtë vit, duke deklaruar të dhëna edhe për znj. M. Në këto kushte, provohet se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me gjendjen e cash-it për vitin 2009. Trupi gjykues mbi këto fakte nuk vlerësoi të marrë në konsideratë deklaratën noteriale³⁷ të ish-bashkëshortes, pasi është realizuar gjatë procesit të rivlerësimit, çka krijon bindjen se akti është konceptuar në favor të deklarameve të subjektit të rivlerësimit.

17.15 Për sa është arsyetuar dhe në kushtet që nga ana e subjektit nuk është paraqitur ndonjë dokument ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmon se shuma e dhuruar nuk duhet të merret në konsideratë dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë në pamundësi financiare për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 40.000 euro, si dhe të përballonin shpenzimet e tjera familjare në shumën -4.857.593 lekë në vitin 2012. Si rrjedhojë e mosmarrjes në konsideratë edhe të pretendimeve të subjektit sa i takon balancave negative për vitet 2010 – 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë kursimet, si dhe, më pas, këto kursime t’i investojë në pasurinë apartament dhe garazh, në një shumë totale prej -6.147.428 lekësh për vitet 2010 – 2012.

17.16 Në përfundim, trupi gjykues çmon se në rrethanat faktike të kësaj çështjeje, subjekti nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke mos paraqitur plotësisht realitetin dhe, për rrjedhojë, ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Këto konkluzione kualifikohen

³⁵ Vendimi nr. 7/2019 (JR), paragrafi 32.5; vendimi nr. 29/2019 (JR), paragrafi 31; vendimi nr. 1/2020 (JR), paragrafi 50; vendimi nr. 31/2021 (JR), paragrafi 25.2; vendimi nr. 26/2022 (JR), paragrafi 18.7.

³⁶ Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4 parashikonte se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të 14 çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.

³⁷ Nr.***, datë 23.05.2023, depozituar nga subjekti në seancë dëgjimore datë 24.05.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, përbëjnë shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

18. Garazh nr. *, me sipërfaqe 22.9 m², në kompleksin rezidencial “****”, S. Njësia Administrative F, Tiranë, me nr. pasurie ***, regjistruar në z. k. ***, vol. ***, f. ***, parapaguar në datën 13.10.2016 me kontratën e premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2016. Burimi i të ardhurave: të ardhura nga paga, të ardhura nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese, dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj. Pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj. Vlera: 7.547 euro. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.**

18.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. Nuk konfirmohet garazhi i deklaruar, pasi është me kontratë premtim shitjeje.*

Hetimi i Komisionit

18.2 Nga hetimi i kryer, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2016, me përshkrimin “Pakësuar gjendja *cash* me pagimin e shumës 7.547 euro, parapaguar në datën 13.10.2016, me kontratën e premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2016, e garazh nr. ***, me sip. 22.9 m², në kompleksin rezidencial “****”, S. Njësia Administrative F, Tiranë, me nr. pasurie ***, regjistruar në z. k. ***, vol. ***, f. ***. Burimi i krijimit: (i) gjendja *cash* e kursyer nga të ardhurat nga paga; (ii) të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; (iii) dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; (iv) pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetueses nga babai i saj”.

18.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar³⁸ në lidhje me këtë pasuri, konstatohet se ASHK-ja ka depozituar kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2016, për premtim shitje pasuri e paluajtshme garazh, me palë shitëse A.S e M.S dhe palë blerëse A.S e Lazër Sallaku. Vlera e garazhit: 7.547 euro. Kjo drejtori ka depozituar edhe marrëveshjen për ndarje pasurie, të cilat Komisioni i ka trajtuar më sipër, ku edhe garazhi ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

18.4 ZQRPP-ja³⁹, me *email*-in datë 24.8.2018, konfirmon se nga riverifikimi në sistemin digjital dhe dokumentacionin që disponon kjo zyrë u konstatua se *pasuria nr. ***, ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 140.60 m², figuron në pronësi të shtetasit G.A.S, me shënimin “k.dh.”, regjistruar në datën 24.5.2017.*

18.5 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

18.5.1 Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer:

- të ardhurat nga paga;
- të ardhurat nga paga të ish-bashkëshortes bashkëjetuese;
- dhuratat e bërë ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj;
- pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj.

18.6 Komisioni e ka trajtuar secilin burim krijimi më sipër, në hetimin e kryer për pasurinë apartament, duke referuar të njëjtin arsyetim dhe, për rrjedhojë, çmon të mos bjerë në përsëritje.

³⁸ Referuar informacionit të dhënë nga ASHK/Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁹ Aneks nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

19. Automjet tip “Volkswagen Golf”, e vitit 2005, me targë ***, blerë me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2015. Burimi i të ardhurave: të ardhura nga paga. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁰.

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i Komisionit

19.2 Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2015, me përshkrimin “Pakësim i gjendjes *cash* me 200.000 lekë pasi është blerë automjetura “Volkswagen”, sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2015, mbajtur nga noter I.H, Dhoma e Noterisë Sh. Burimi i krijimit: gjendja *cash*”.

19.3 DPSHTRR-ja⁴¹ informon se z. Lazër Sallaku ka të regjistruar automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka përcjellë kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2015, me palë shitëse B.D.D dhe palë blerëse Lazër L. Sallaku, për automjetin tip “Volkswagen”, në vlerën 200.000 lekë.

19.4 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhurat nga pagat, ndërsa në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash*.

19.4.i Sa i përket deklarimit të kursimeve në *cash*, Komisioni i ka pasqyruar shtesat/pakësimet në tabelën nr. 2, trajtuar/arsyetuar më sipër në këtë vendim dhe, për rrjedhojë, çmon të mos bjerë në përsëritje.

19.4.ii Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2015, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të investojë në pasurinë e luajtshme automjet, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Detyrimet financiare

20. Kontribut për detyrim ushqimor për fëmijën e mitur O.S, sipas vendimit nr. *** , datë 22.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në shumën 10.000 lekë/muaj. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴².

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.*

Hetimi i Komisionit

20.2 Subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar gjendjen e tij civile, divorcuar me vendimin nr. *** , datë 22.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërsa në DPV-në e vitit 2011, në rubrikën e detyrimeve financiare, ka deklaruar detyrimin për “Pension ushqimor për fëmijën e mitur O.S, sipas vendimit nr. *** , datë 22.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shuma e

⁴⁰ Leje qarkullimi nr. *** , lëshuar në datën 28.9.2015, të automjetit tip “Volkswagen Golf”, me nr. shasje *** , prodhuar në vitin 2005, me targë *** , në emër të shtetasit Lazër Sallaku; certifikatë pronësie të automjetit tip “Volkswagen Golf”, me nr. shasje *** , prodhuar në vitin 2005, me targë *** , në pronësi të shtetasit Lazër Sallaku; kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2015, për shitjen nga shtetasi B.D, të automjetit tip “Volkswagen Golf”, me nr. shasje *** , në shumën 200.000 lekë shtetasit Lazër Sallaku; deklaratë doganore nr. *** , datë 29.5.2015, në emër të shitësit. Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴² Vendim nr. *** prot., datë 22.12.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur se shtetasi Lazër Sallaku ka detyrimin për kontribut ushqimor për fëmijën e mitur O.S, në shumën 10.000 lekë/muaj; aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2010, për ndarjen e pasurisë bashkëshortore dhe për caktimin e detyrimeve dhe të drejtave për fëmijën e mitur O.S; shtojcë aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2009, për caktimin e detyrimeve dhe të drejtave për fëmijën e mitur O.S. Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

shlyer është 120.000 lekë (10.000 lekë/muaj)”. Këtë detyrim subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore pasuese (2012, 2014, 2015 e 2016), përveç vitit 2013.

20.3 Nga hetimi rezultoi se sipas vendimit nr. *** prot., datë 22.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrimi ushqimor për fëmijën e mitur O.S është në shumën 10.000 lekë/muaj.

20.4 Në analizë të të dhënave të dala nga hetimi, Komisioni ka konstatuar se **përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.**

20.5 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka zgjidhur martesën me shtetasen A.S, sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 30.6.2015. Sipas këtij vendimi, z. Lazër Sallaku do të paguajë pension ushqimor në masën 20.000 lekë/muaj, si kontribut për fëmijën E.S.

20.6 Komisioni e ka pyetur subjektin⁴³ lidhur me detyrimet ushqimore për fëmijët e tij, i cili, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Shpenzimet vjetore për detyrimin ushqimor për fëmijën tim O.S për vitet 2010 – 2016 kanë qenë 10.000 lekë/muaj, në total 720.000 lekë. Shpenzimet vjetore për detyrimin ushqimor për fëmijën tim E.S për vitet 2015 – 2016 kanë qenë 20.000 lekë/muaj, në total 480.000 lekë”*.

20.7 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, pasi dukej se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, për shkak se nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* detyrimin ushqimor për fëmijën e mitur E.S.

20.8 Në qëndrimin e tij lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se *detyrimi ushqimor sipas vendimit të gjykatës të zgjidhjes së martesës ka qenë 20.000 lekë/muaj dhe, duke qenë se direkt pas zgjidhjes së martesës ai ka vazhduar të bashkëjetojë me ish-bashkëshorten A.S dhe me fëmijën e mitur E.S, nuk e ka deklaruar si shpenzim sipas vendimit të gjykatës, pasi kanë pasur ekonomi familjare të përbashkët në bashkëjetesë.*

20.9 Trupi gjykues, në analizë të provave e fakteve të dala nga hetimi në raport me pretendimin e subjektit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht arsyeve të paraqitura, ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë detyrim që rridhte nga vendimi gjyqësor. Por ky mosdeklaram vlerësohet nga trupi gjykues si pasaktësi pa pasoja në procesin e tij dhe, si i tillë, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Deklarimi i pasurive të ish-bashkëshortes/bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. A.Si

21. Automjet tip “Daimler Chrysler”, me targë *,** blerë sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2014, mbajtur nga notere SH.GJ, Dhoma e Noterisë Tiranë. Burimi i të ardhurave: shitja e apartamentit me sip. 57.6 m². Adresa e pasurisë L, Tiranë, pasuria nr. ***, përfituar me trashëgimi nga babai i saj sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2013. Vlera: 7.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar disa dokumente⁴⁴.

⁴³ Pyetësor nr. 2, datë 27.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ Leje qarkullimi nr. ***, lëshuar më 24.9.2016, të automjetit tip “Daimler Chrysler”, me nr. shasie ***, prodhuar në vitin 2007, me targë ***, në pronësi të shtetasen A.S; certifikatë pronësie mjeti rrugor nr. ***, lëshuar më 24.9.2016, për automjetin tip “Daimler Chrysler”, me nr. shasie ***, prodhuar në vitin 2007, me targë ***, në pronësi të shtetasen A.S; kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2014, për shitjen nga shtetasi SH.S të automjetit tip “Daimler Chrysler”, me nr. shasie ***, prodhuar në vitin 2007, me targë ***, në shumën 7.000 euro (blerëse A.S); deklaratë doganore nr. ***, datë 18.12.2011, në emër të shitësit; dëshmi trashëgimie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2013, me të cilën bashkëjetuesja e subjektit ka fituar të drejtën e trashëgimisë si trashëgimtare ligjore me ½ pjesë të trashëgimlënësit S.S; kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.2011, për blerjen e apartamentin nr. ***, me sipërfaqe totale 65 m², në vlerën 26.000 euro, nga shtetasi S.S, likuiduar tërësisht; plan rievimi i sipërfaqes totale 65 m² të apartamentit; kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme (me rezervë, me kusht) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2014, për blerjen e apartamentin me nr. pasurie ***, ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 57.6 m², në vlerën 32.000 euro (palë shitëse E.S e A.S dhe palë blerëse E.M e V.M). Shuma e çmimit prej 4.500.000 lekësh do të paguhet: shuma 1.700.000 lekë ose kundërvlehtë e saj në euro, 12.000 euro, i paguhet shitësve nëpërmjet pagesës në llogarinë e transaksioneve të noterit pranë NBG Bank; diferenca prej 2.800.000 lekësh ose kundërvlehtë e saj në euro,

21.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i Komisionit

21.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2014, me përshkrimin “Pakësuar gjendja *cash* me 7.000 euro pasi është blerë autovetura “Daimler Chrysler”, sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2014, mbajtur nga notere SH.GJ, Dhoma e Noterisë Tiranë”.

21.3 DPSHTRR-ja⁴⁵ informon se znj. A.S.S ka pasur në pronësi automjetin me targë ***⁴⁶. Kjo drejtori ka përcjellë kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.9.2014, me palë shitëse SH.B.S dhe palë blerëse A.S.S, për automjetin tip “Daimler Chrysler”, në vlerën 7.000 euro. Ky automjet rezultoi të jetë shitur më 25.6.2018, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** kol., në vlerën 5.000 euro.

21.4 Komisioni, të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 57.6 m², me adresë L, Tiranë⁴⁷, të cilat janë përdorur si burim krijimi për pasurinë objekt hetimi, i ka trajtuar më sipër në këto rezultate dhe nuk i kanë rezultuar problematika.

21.5 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2015, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare të investojnë në pasuri të luajtshme, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

22. Apartament me nr. pasurie *, i ndodhur në S, Tiranë**, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe fizike 86.30 m², sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 8.11.2016 nga ZVRPP-ja Tiranë. Burimi i të ardhurave: të ardhurat nga paga, të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortit bashkëjetues, dhurata e bërë nga nëna. Pjesa e trashëgimisë nga babai. Vlera: 46.322 euro. Pjesa takuese: 50 %.

22.1 Garazh nr. *, me sipërfaqe 22.9 m², në kompleksin rezidencial “***”, S**, Njësia Administrative F, Tiranë, me nr. pasurie ***, regjistruar në z. k. ***, vol. ***, f. ***, parapaguar në datën 13.10.2016 me kontratën e premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2016. Burimi i të ardhurave: të ardhurat nga paga, të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortit bashkëjetues, dhurata e bërë nga nëna. Pjesa e trashëgimisë nga babai. Vlera: 7.547 euro. Pjesa takuese: 50%.

22.2 Komisioni e ka trajtuar hetimin e këtyre pasurive (apartament + garazh) në pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, për trupin gjykues qëndron i njëjti arsyetim dhe vlerësim, në kushtet kur janë shqyrtuar të njëjtat pasuri dhe, për rrjedhojë, çmon të mos bjerë në përsëritje.

Deklarimi i pasurive të djalit të subjektit – K.S (fëmijë madhor i ndarë nga subjekti)

23. Automjet tip “Volkswagen Golf”, vit prodhimi 1999, me targë ***, dhuruar nga babai, sipas kontratës së dhurimit të automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2017, mbajtur nga notere

20.000 euro, do të paguhet në llogarinë bankare të shitësve pranë NBG Bank nëpërmjet një kredie që blerësit do të marrin pranë kësaj banke; certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar më 9.1.2014, në pronësi të shtetaseve A. dhe A.S (S), në bashkëpronësi me pjesë të barabartë; kopje kartele lëshuar në datën 14.7.2014, në pronësi të A. dhe A.S (S) në bashkëpronësi me pjesë të barabartë; Hartë treguese e regjistrimit të pronës; Kopje kartash identiteti të palëve; transaksion bankar, datë 8.8.2014, në vlerën 32.000 euro, për pagesën totale të apartamentit nga E.M tek A. dhe E.S; transaksion bankar, datë 29.8.2014, nga NBG Bank, nga A.S, në shumën 16.000 euro, me përshkrimin “Tërheqje nga shitja e apartamentit (mbajtës të llogarisë A.S dhe E.S)”. Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020.

⁴⁶ Gjatë periudhës që ka qenë në pronësi të shtetases A.S, targa e këtij mjeti ka qenë ***, më pas është ndryshuar nga pronarët e tjerë.

⁴⁷ Konfirmuar si pasuria me nr. ***, përfutur me trashëgimi nga babai i saj sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2013.

E.K, Dhoma e Noterisë Tiranë. Pa vlerë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁸.

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e DPSHTRR-së.*

Hetimi i Komisionit

23.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi dhurimin e mjetit në DPV-në e vitit 2016, me përshkrimin “Dhuruar djalit K.S autovetura “Volkswagen Golf”, e vitit të prodhimit 1999, me targë ***, sipas kontratës së dhurimit për automjetin me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016, mbajtur nga notere E.K, Dhoma e Noterisë Tiranë”.

23.3 DPSHTRR-ja⁴⁹ informon se shtetasi K.S ka të regjistruar automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka depozituar kontratën e dhurimit të automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016, me palë dhuruese shtetasin Lazër Sallaku dhe palë pranuese e dhurimit shtetasi K.S, për automjetin tip “Volkswagen”, me targë ***.

23.4 Subjekti e ka blerë më parë këtë automjet nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2009, në vlerën 5.800 euro.

23.5 Lidhur me blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, nga hetimi Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009 se kjo pasuri është blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2009, në vlerën 5.800 euro.

23.6 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se burim krijimi për blerjen e këtij automjeti ka shërbyer kredia konsumatore e marrë nga ish-bashkëshortja, shtetasja A.M (S), në “Raiffeisen Bank”, në shumën 900.000 lekë.

23.7 DPSHTRR-ja⁵⁰ informon se shtetasi Lazër L. Sallaku ka pasur në pronësi automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2009, me palë shitëse E.D dhe palë blerëse Lazër Sallaku, për automjetin tip “Volkswagen Golf”, në vlerën 5.800 euro.

23.8 “Raiffeisen Bank”⁵¹ informon se shtetasja A.A.S (M) ka marrë një kredi në shumën 900.000 lekë, në datën 14.4.2009, mbyllur në datën 17.5.2011.

23.9 Nga analizimi i *statement*-it të llogarisë së shtetasës A.M vihet re se në datën e disbursimit të kredisë, 14.4.2009, ajo ka tërhequr shumën 800.000 lekë.

23.10 Komisioni, bazuar në faktet e dala nga hetimi, nuk konstaton problematika lidhur me deklarin dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

24. Vajza e subjektit S.S (fëmijë madhor i ndarë nga subjekti), ka firmosur autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku deklaroi se disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.

⁴⁸ Leje qarkullimi për automjetin me targë ***, në pronësi të shtetasit K.S, lëshuar më 25.10.2016; certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar më 25.10.2016; deklaratë doganore nr. ***, datë 26.3.2009, në emër të shtetasit E.D; Kontratë dhurimi automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016, me palë dhuruese Lazër Sallaku dhe pranues dhurimi K.S, të automjetit me targë ***, me nr. shasie ***; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, i DPSHTRR-së, nëpërmjet të cilit vërtetohet se automjeti me targë *** është në pronësi të shtetasit Lazër Sallaku; rezultat kërkimi nga “Raiffeisen Bank”, lëshuar më 18.10.2016; kopje kartash identiteti të palëve. Aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020.

⁵⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020.

⁵¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020.

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Rezulton se nuk ka deklaruar pasuri dhe nuk ka bashkëngjitur ndonjë dokumentacion në emër të vajzës S.S.*

24.2 Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike nuk është konfirmuar ndonjë pasuri e paluajtshme apo e luajtshme në adresë të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

Konstatime të tjera

25. Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore investime në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, përveç atyre të deklaruara në deklaratën *Vetting*, dhe specifikisht, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2007, subjekti ka deklaruar:

- Shtëpi banimi me sip. 110 m², vit ndërtimit 2007, Tiranë, rruga “****”, pallati nr. ***, apartamenti nr. ***. Vlera: 60.000 euro.
- Automjet tip “Mitsubishi Pajero”. Vlera: 700.000 lekë.
- Motoskaf. Vlera: 300.000 lekë.

25.1 Komisioni hetoi për secilën nga këto pasuri për të parë mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit.

25.2 Në lidhje me blerjen e pasurisë apartament, rezulton se në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2007, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar:

25.2.1 Kredi për shtëpi në “Alpha Bank”, me kontratë huaje nr. ***, datë 26.11.2007, fillon më 30.11.2007. Shuma e mbetur: 60.000 euro.

25.2.2 Kontratë huaje me “Tirana Bank”, me nr. ***, nga data 27.8.2007 deri më 27.8.2008. Shuma e mbetur: 216.000 lekë.

25.3 Nga hetimi rezultoi se subjekti ka depozituar në ILDKPKI⁵² kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2007, me palë, në cilësinë e sipërmarrësit, shoqërinë “****”, dhe në cilësinë e investitorit Lazër L. Sallaku. Çmimi në kontratë përcaktohet në shumën 60.000 euro + 110.000 lekë. Në kontratë është parashikuar se e gjithë vlera do të paguhej pas lëvrimit të kredisë deri në datën 20.11.2007.

25.4 “Alpha Bank”, me *email*-in e datës 25.9.2018⁵³, ka konfirmuar se shtetasi Lazër Sallaku në vitin 2007 është financuar nga kjo bankë në shumën 60.000 euro dhe në vitin 2016 kredia është ristrukturuar në shumën 45.800 euro. Sipas kontratës së kredisë⁵⁴ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.11.2007, mes “Alpha Bank” dhe kredimarrësit Lazër Sallaku e A.S, banka i çel kredimarrësit kufirin e kredisë në shumën 63.000 euro. Kufiri i kredisë mund të shtohet ose pakësohet vetëm sipas kushteve të kësaj kontrate. Nga plani i amortizimit konstatohet se kredia është disbursuar në vlerën 60.000 euro.

25.5 Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është divorcuar me vendimin nr. ***, datë 22.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ai ka deklaruar se shtëpia e banimit dhe kredia në “Alpha Bank” i kanë kaluar vetëm ish-bashkëshortes A.S, sipas vendimit të gjykatës.

25.6 Nga verifikimi i të dhënave të administruara⁵⁵ vihet re se me vendimin nr. ***, datë 22.12.2010, është vendosur zgjidhja e martesës ndërmjet shtetasve A.S dhe Lazër Sallaku. Sipas aktmarrëveshjes (për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok) datë 28.7.2010, palët kanë rënë dakord, ndër të tjera, që apartamenti me sip. 110m², godina nr. ***, apartamenti nr. ***, kati ***, Tiranë, blerë me kredi në

⁵² Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020.

⁵³ Aneks nr. 10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴ Administruar nga dokumentacioni i përcjellë nga “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020.

⁵⁵ Referuar aneksit nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

“Alpha Bank” në shumën 60.000 euro, t’i kalojë shtetas A.M (S) me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me këtë apartament (përfshirë edhe likuidimin e kredisë në “Alpha Bank).

25.7 ASHK/Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁵⁶ informon se në emër të shtetas A.A.M (S) figuron e regjistruar pasuria në z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 98.8 m². Kjo drejtori ka depozituar:

- i) kartelën e pasurisë për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 98.8 m², në pronësi të shtetas A.A.M;
- ii) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2019, për blerjen e apartamentit nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe neto 98.8 m², në vlerën 7.500.000 lekë, me palë shitëse “****” dhe palë blerëse A.M. Sipas kontratës, çmimi për blerjen e kësaj pasurie është likuiduar totalisht që në datën 30.11.2007.

25.8 Gjithashtu, nga analizimi i llogarisë bankare në “Alpha Bank”⁵⁷ vihet re se këstet e kredisë janë likuiduar nga shtetasja A.M, sipas aktmarrëveshjes së divorcit.

25.9 Në lidhje me dy pasuritë e luajtshme, automjetin tip “Mitsubishi Pajero” dhe motoskafin, për shkak të blerjes në një kohë të largët dhe më pas tjetërsimit të tyre, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të sigurojë kontratat e blerjes.

25.10 Për mjetin lundruer motoskafe, edhe nga korrespondenca e mbajtur nga ana e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme Detare⁵⁸ konfirmohet se nuk është mundur të gjendet kontrata e blerjes për shkak të djegies së arkivave në vitin 1997.

25.11 Ndërsa për automjetin tip “Mitsubish Pajero”, nga korrespondenca e mbajtur nga ana e Komisionit me DPSHTRR-në⁵⁹, kjo e fundit ka vendosur në dispozicion kontratën e shitblerjes nr. *** regj., nr. *** kol., datë 8.7.2003, me palë shitëse A.D.C dhe palë blerëse Lazër Sallaku. Vlera e mjetit: 180.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një vlerë më të lartë blerjeje për këtë mjet, konkretisht 700.000 lekë.

25.11.1 Lidhur me këtë konstatim, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, i cili në qëndrimin e tij ka shpjeguar se nuk është bërë me qëllim, pasi është rritje e vlerës së shpenzuar, nuk kishte ndonjë avantazh për të të deklaronte një vlerë më të madhe blerjeje, pra është e vërtetë ajo çfarë pasqyrohet në kontratë.

25.11.2 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të dala përgjatë hetimit dhe në raport me shpjegimet e subjektit, çmon se vlera reale e mjetit është ajo e deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të kohës, argument ky duke u krahasuar edhe me vlerën e shitjes së tij.

25.12 Komisioni ka vlerësuar që për të dyja mjetet të marrë në konsideratë si vlerë investimi ato të deklaruara nga ana e subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2007.

25.13 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij dhe shoqërisë së ndërtimit “****”, në cilësinë e shitësit të pasurisë.

25.14 Në përgjigjen e dhënë⁶⁰ subjekti ka deklaruar se nuk rezultojnë çështje gjyqësore që të jenë gjykuar nga ana e tij si gjyqtar gjatë ushtrimit të detyrës si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ashtu edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2020.

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2023.

⁶⁰ Me pyetësonin nr. 5, datë 19.4.2023, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

25.15 Subjekti ka depozituar konfirmimin e gjykatës, ku vërtetohet se subjekti nuk ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me këtë shoqëri ndërtimore dhe as me administratorin e saj, shtetasin I.J.K.

25.16 Komisioni vlerësoi që analizën financiare ta kryejë për periudhën 2003 – 2007, duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar si vijon:

a. Subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2007 të ardhura nga aktiviteti privat avokat. Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit figuron i regjistruar në gjykatë me vendim nr. ***, datë 12.12.2000, për llojin e biznesit “Avokati”, të dhëna këto sipas certifikatës⁶¹ së regjistrimit tatimor, me kod fiskal ***.

b. Gjithashtu, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë⁶² informon se Lazër L. Sallaku është i regjistruar si person fizik me NIPT *** për periudhën 14.12.2000 – 4.4.2012. Kjo drejtori ka informuar edhe për xhiron e realizuar apo deklaruar për vitet 2003 – 2006.

c. Komisioni vlerësoi të përllorarisë fitimin nga ky aktivitet në masën 80%, si më poshtë pasqyruar:

Tabela nr. 3

Viti	Xhiro e realizuar/parashikuar	Fitimi 80%
2003	150,000	120,000
2004	360,000	288,000
2005	360,000	288,000
2006	600,000	480,000
Total	1,470,000	1,176,000

ç. Të ardhurat nga pagat për vitet 2005 – 2007 për subjektin janë marrë sipas *statement*-it bankar në “Raiffeisen Bank”. Rezulton se subjekti është paguar nga institucione shtetërore si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve⁶³ për vitet 2005 – 2006, Porti Detar Shëngjin dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë për vitet 2007 – 2010⁶⁴.

d. Lidhur me punësimin e bashkëshortes A.S (M), në atë kohë, subjekti ka deklaruar⁶⁵ se: “*Ish-bashkëshortja A.M (S) ka qenë e punësuar pranë institucionit “****” sh.p.k. (përpara 2010 njohur me emrin “****”, program i “World Vision Albania”; prej janarit 2010 deri në dhjetor 2016 njohur me emrin “****” sh.p.k.) me NIPT ***. Ajo ka qenë e punësuar pranë këtij institucioni për periudhën nga 15 maji 2002 deri në 31 dhjetor 2007*”.

dh. Komisioni mbajti korrespondencë me ISSH/Drejtorja e Arkivit Qendror, e cila në përgjigje⁶⁶ ka konfirmuar si periudhë punësimi për shtetasen A.S, qershor 2004 – dhjetor 2007, si dhe ka konfirmuar edhe të ardhurat e realizuara mbi kontributet e derdhura nga subjekti “****”.

e. Komisioni përlloraritë të ardhurat neto për këtë punësim, sipas legjislacionit të kohës.

ë. Të ardhurat nga kreditë dhe shpenzimet për likuidimin e kësteve janë marrë në konsideratë sipas *statement*-it bankar.

⁶¹ Depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 2, datë 27.3.2023.

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2023, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, depozituar me pyetësin nr. 2, datë 27.3.2023.

⁶⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁵ Në pyetësin nr. 2, datë 27.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2023.

25.17 Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003 – 2007, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në pasuritë e luajtshme dhe atë të paluajtshme, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

26. Nga aksesi i Komisionit në sistemin AMF rezulton se shtetasja A.S (S) ka qenë pronare e automjetit tip “Audi A4”, me targë ***. Rezultoi se ky mjet ka qenë në përdorim edhe nga shtetasi F.K.

26.1 Subjektit i është kërkuar të deklarojë dhe të dokumentojë⁶⁷ pronësinë e këtij mjeti, tjetërsimin e tij nëse ka ndodhur, si dhe marrëdhënien e tij me shtetasin F.K. Gjithashtu subjektit i është kërkuar të deklarojë nëse ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse apo kërkuar këtë shtetas.

26.2 Subjekti ka deklaruar se pronarja e automjetit tip “Audi A4”, me targë ***, shtetasja A.S, nuk është i njëjti person me ish-bashkëshorten e tij, por është një shtetase tjetër me të njëjtin emër. Subjekti ka deklaruar se ish-bashkëshortja e tij A.S e ka marrë mbiemrin Sallaku në datën 5.6.2012, me lidhjen e martesës me të, ndërsa pronarja e mjetit e ka blerë këtë automjet me kontratën e shitjes, përpiluar në Itali dhe e noterizuar firma e përkthyeses me datë 20.7.2009. Në atë kohë ish-bashkëshortja, deklaroi subjekti, ka qenë A.S dhe jo Sallaku. Kjo shtetase është e datëlindjes 3.4.1986, ndërsa ish-bashkëshortja është e datëlindjes 5.5.1986. Pra, nuk ka qenë asnjëherë pronare e këtij mjeti. Subjekti ka deklaruar se nuk e di kush është shtetasi F.K. Ai ka sqaruar se nga verifikimi i bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi se me vendimin penal nr. ***, datë 3.11.2021, të kësaj gjykate, ka gjykuar të pandehurin F.B, i cili ka mbajtur më parë edhe emrin F.K, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, parashikuar nga neni 321/2 i Kodit Penal dhe me këtë vendim është deklaruar fajtor dhe dënuar me 3 muaj burgim, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i është ulur 1/3 e masës së dënimit dhe është dënuar përfundimisht me 2 muaj burgim. Vendimi është ankimuar dhe ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

26.3 Subjekti ka depozituar kopje të akteve nga dosja e automjetit tip “Audi A4”, me targë ***, kopje të vendimit penal nr. ***, datë 3.11.2021, të kësaj gjykate, shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023, me lëndë “Kthim përgjigje”, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lëshuar nga zv/kryetari i asaj gjykate, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2023, me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

26.4 Në analizë të përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni nuk konstatoi *indicie* për të krijuar dyshime në lidhje me këtë çështje.

27. Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se në udhëtimet e kryera nga subjekti jashtë Republikës së Shqipërisë, ky i fundit, për udhëtimin në datat 16.8.2011 – 23.8.2011 ka përdorur mjetin me targë ***.

27.1 Subjekti është pyetur⁶⁸ për pronarin e mjetit, marrëdhënien që ka me të, si dhe nëse ka gjykuar çështje të çdolloj natyre.

27.2 Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar se në lidhje me këtë automjet ka dhënë sqarime në përgjigje të pyetjes nr. 8 “Pyetjet standarde”. Ai ka rikonfirmuar edhe një herë përgjigjen, duke sqaruar se *gjatë periudhës së deklaramit ka drejtuar disa herë në raste të rralla automjet në pronësi të një shoku të ish të fejuarit të vajzës së tij të madhe, S.S, shtetasit D.M. Konkretisht të automjetit tip autoveturë me targë ***, në pronësi të subjektit privat “****” që, me sa mban mend, administrohej nga shtetasi i mësipërm. Këtë automjet e ka marrë në raste të rralla, në cilësinë e mbajtësit të thjeshtë, kur ka pasur udhëtime të gjata, pasi shtetasi i mësipërm kishte edhe automjete të tjera dhe e ka ndihmuar duke ia dhënë automjetin për shkak të lidhjes së mësipërme. Ai ka sqaruar se me personin në fjalë nuk ka kontakte pas prishjes së fejesës me vajzën e tij dhe se nuk disponon dokumente provuese.*

⁶⁷ Me pyetësin nr. 5, datë 19.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁸ Me pyetësin nr. 5, datë 19.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

27.3 Subjekti ka deklaruar se nuk ka gjykuar me palë ndërgjyqëse shtetasin D.M apo me subjektin privat “***” në pronësi të të cilit është automjeti.

27.4 Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023, me lëndë “Kthim përgjigje”, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2023, me lëndë “Kthim përgjigje”, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga verifikimi i së cilës konfirmohet ky fakt.

28. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.1999, automjetin tip “Mercedes-Benz” në vlerën 700.000 lekë, me targë ***, nga shtetasi S.K. Ky mjet, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 6.2.2012, rezultoi i hequr nga qarkullimi në datën 26.3.2012.

28.1 Komisioni e ka pyetur subjektin⁶⁹ se përse nuk është deklaruar ky mjet në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2007, si dhe nxjerrja nga qarkullimi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012. Njëkohësisht subjekti është pyetur në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe i është kërkuar të depozitohet dokumentacion i justifikues.

28.2 Subjekti ka deklaruar se e ka blerë automjetin në datën 5.10.1999 me të ardhurat familjare ndër vite, përfituar nga paga, nga viti 1988 deri në vitin 1999. Gjithashtu ka deklaruar: *“Rreth vitit 2005 kjo makinë ka dalë jashtë përdorimit për shkak të amortizimit, pasi, me sa mbaj mend, ka qenë e vitit 1982 dhe e kam lënë tek oborri i një kushëriri që e kishte shtëpinë me oborr dhe garazh, në qytetin e Lezhës, praktikisht ia kam falur atij, por pa bërë veprime konkrete për kalim pronësie, pasi nuk kishte vlerë si automjet. Ai kishte një automjet të ngjashëm, por prodhim më të ri dhe e kishte në gjendje pune. Me sa di unë e ka përdorur për pjesë për makinën e tij. E kam neglizhuar faktin se duhet të bëhej kërkesë për ta çregjistruar, madje duke mos u thelluar, e kam menduar se po të mos paguheshin taksat dilte automatikisht nga qarkullimi”*. Subjekti ka deklaruar se kur është vënë në dijeni në vitin 2012 që nuk është çregjistruar, ka bërë kërkesë për çregjistrim, i cili është bërë formalisht. Ai ka deklaruar se *makina nuk ka qenë në qarkullim pas vitit 2005, ka qenë jashtë përdorimit, nuk ka pasur vlerë si pasuri, kështu që nuk e ka deklaruar si pasuri të luajtshme në deklarinimin fillestar*. Gjithashtu, ka deklaruar ai, për këtë shkak nuk e ka deklaruar veprimin formal të çregjistrimit as kur është bërë formalisht në vitin 2012. Subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumente provuese.

28.3 Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pasaktë në deklaratën e viteve 2007 dhe 2012 në lidhje me ekzistencën e mjetit në pronësi të tij deri në vitin 2012, pasaktësi e cila vlerësohet pa impakt në procesin e rivlerësimit të subjektit.

29. Nga hetimi rezultoi se subjekti ka deklaruar në DVP-në e viteve 2012 – 2015 si adresë të regjistrimit në gjendjen civile adresën “Tiranë 1, ***, p. ***”.

29.1 Subjekti është pyetur⁷⁰ lidhur me këtë adresë, marrëdhënien me të, si dhe titullarin e kësaj pronësie, nga ku ka deklaruar se adresën e regjistrimit në gjendjen civile “Tiranë 1, ***, p. ***” e ka marrë “aksidentalisht” me lidhjen e martesës me ish-bashkëshorten, shtetasen A.S, në datën 5.6.2012. Subjekti ka sqaruar se *kjo është adresa që ka pasur ish-bashkëshortja A.S nga martesja e saj e parë dhe, me sa ka qenë në dijeni, është pikërisht adresa e ish-bashkëshortit të saj të parë dhe se ai nuk ka lidhje reale me këtë adresë banimi*. Subjekti ka sqaruar se e ka deklaruar këtë adresë gjatë deklarinimit të pasurive, pasi kjo adresë i dilte në dokumentet e gjendjes civile. Ai ka deklaruar se celebrimi është bërë pak i nxituar, pasi i kishte lindur vajza E.S dhe duhej ta regjistronin.

29.2 Subjekti ka depozituar si dokument justifikues certifikatën e martesës, lëshuar më 27.4.2015, si dokumentin e vetëm që disponon.

⁶⁹ Me pyetësorin nr. 5, datë 19.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁰ Me pyetësorin nr. 7, datë 27.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

29.3 Nga verifikimi i certifikatës, Komisionit i rezultoi se identifikohet adresa e banimit, sikurse subjekti ka deklaruar në DPV-të e viteve 2012 – 2015. Gjithashtu, nga aksesi *online* në regjistrin e gjendjes civile konfirmohet se ish-bashkëshorti i znj. A.S, shtetasi I.K, ka pasur si adresë banimi po rrugën “***”. Për sa është konstatuar e konfirmuar nga hetimi, Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

B. KONTROLI I FIGURËS

30. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Lazër Sallaku.

30.1 Nga hetimi i Komisionit për vlerësimin e këtij kriteri, rezultoi se DSIK-ja⁷¹ në informacionin e përcjellë konfirmon se nuk disponon të dhëna të përditësuara për përfshirje të subjektit në veprimtari të kundërligjshme.

30.2 Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e tij sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

31. Raporti është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

31.1 Raporti⁷² ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

31.2 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore.

⁷¹ Mbi kërkesat e Komisionit nr. *** prot., datë 29.3.2022 dhe nr. *** prot., datë 28.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷² Nr. *** prot., datë 26.10.2020

32. Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

i. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimi konkludoi t “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Lazër Sallaku janë paraqitur 7 ankesa (2 në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

- Tri ankesa (1 e vitit 2015 dhe 2 të vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi pretendimet respektive për ligjshmëri vendimi zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

- Katër ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë: 3 ankesa (2 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015), verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, ndër të cilat për 1 ankesë është sugjeruar evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional i shkeljes, për 1 tjetër nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari dhe për 1 ankesë është sugjeruar tërheqje vërejtje me shkrim, e cila i mbahet parasysh në vlerësimin etik e profesional.

ii. Komisioni i ka kërkuar subjektit⁷³ të shpjegojë lidhur me dy ankesat⁷⁴, për të cilat KLD-ja ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka arritur në konkluzione të caktuara.

iii. Subjekti ka dhënë shpjegime për secilin ankim dhe njëkohësisht ka depozituar edhe praktikatat përkatëse. Më konkretisht:

iv. Subjekti, në lidhje me ankesën nr. *** prot., datë 5.5.2015, me ankues V.Ç, ka shpjeguar se ai është njoftuar për ankesën fillimisht, por më pas nuk është pyetur dhe nuk është njoftuar asgjë në lidhje me konkluzionet e verifikimit. Subjekti ka deklaruar se në lidhje me këtë ankim nuk rezulton të ketë një vendimmarrje të KLD-së ndaj tij dhe se është vetëm një komunikim i kryeinspektores me ankuesin, me objekt “Kthim përgjigje”, datë 5.5.2015.

v. Subjekti ka sqaruar edhe në lidhje me konstatimin në kthim përgjigjen përkatëse ndaj ankuesit, ku përshkruhet se: *“Janë konsumuar gjithsej 9 seanca përgatitore dhe 13 seanca gjyqësore. Nga këto, 2 seanca janë shtyrë me kërkesën tuaj, 5 seanca janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokurorit, megjithëse kishte marrë njoftim të rregullt. Ndërsa, 1 seancë është shtyrë për të kryer gjykata verifikim të pretendimeve tuaja dhe në seancën e fundit është shpallur vendimi. Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se gjyqtari Lazër Sallaku ka bërë të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur zhvillimin e gjykimit brenda afatit ligjor. Shkak të tejzgjatjes së gjykimit evidentojmë afatin e gjatë kohor (1 muaj e 10 ditë) në të cilin gjyqtari e ka mbajtur dosjen pa e vënë në lëvizje. Në këto rrethana, bazuar në nenin 34, pika 2 e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, gjyqtarit Lazër Sallaku do t’i tërhiqet vëmendja me shkrim për zvarritje të gjykimit, akt i cili do të jetë pjesë e dosjes së vlerësimit etik dhe profesional të tij.”*

vi. Subjekti thekson se, sikurse thuhet edhe në përgjigjen e kthyer, ai ka bërë të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur zhvillimin e gjykimit brenda afatit ligjor.

vii. Në lidhje me konstatimin e kryeinspektores se është vlerësuar që subjekti ka mbajtur dosjen pa e vënë në lëvizje për 1 muaj e 10 ditë, subjekti ka sqaruar se nuk qëndron ky pretendim i saj, pasi nuk është mbajtur pa e vënë në lëvizje, por kjo është koha që është dashur për të njoftuar palët për seancën gjyqësore, në mënyrë të tillë që të kthehej fletëthirrja e konfirmuar - marrja dijëni dhe të kishin kohën e nevojshme për t’u përgatitur, siç parashikon neni 333 i Kodit të Procedurës Penale “Caktimi i seancës”, ku thuhet: *“1. Brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të dëmtuarit akuzues, kryetari i trupit gjykues i ngarkuar për gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore. 2. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre*

⁷³ Me pyetësorin nr. 6, datë 24.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁴ Nr. *** prot., datë 9.12.2014, me ankues P.P dhe nr. *** prot., datë 5.5.2015, me ankues V.Ç, sipas të dhënave statistikore administruar në dosjen e Raportit të Vlerësimit Profesional.

të paktën 10 ditë para datës së caktuar për gjykim". Nën këto argumente, subjekti ka pretenduar se konstatimi i kryeinspektore është i pasaktë dhe alogjik.

viii. Nga verifikimi i akteve konfirmohet zhvillimi i seancave gjyqësore, shtyrja e tyre, duke pasqyruar edhe shkaqet e shtyrjeve, si dhe zhvillimi i seancës së parë nga subjekti i rivlerësimit pas 1 muaji e 10 ditësh nga shortimi i çështjes pranë këtij gjyqtari.

ix. Po nga verifikimi i praktikës rezultoi se çështja ka nisur gjykimin prej datës 25.11.2013 nga një tjetër subjekt rivlerësimi, me prezencë të palëve (konfirmuar nga procesverbali i datës 25.11.2013), çka do të thotë se ajo nuk është regjistruar dhe marrë në gjykim nga subjekti i rivlerësimit, porse ky i fundit e ka marrë për gjykim pas zhvillimit të dy seancave gjyqësore për shkak të përjashtimit të subjektit tjetër të rivlerësimit nga trupa gjyqësore (pasi përjashtimi ishte kërkuar nga kërkuesi Ç). Konfirmohet se palët, përkatësisht kërkuesi dhe përfaqësuesi i organit të akuzës në seancën e parë gjyqësore (zhvilluar me tjetër subjekt rivlerësimi), kanë dhënë shpjegimet e tyre dhe se caktimi i vijueshmërisë së seancës nga subjekti i rivlerësimit do të duhej të ishte bërë bazuar në nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku shprehimisht thuhet: *"2. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor vetëm për arsye të veçanta, deri në 15 ditë"*. Ndërkohë, sipas procesverbalit datë 8.4.2014, rezulton se organit të akuzës i është lënë afat njoftimi një muaj kohë (në procesverbal thuhet se përfaqësuesi i organit të akuzës është njoftuar nga gjykata me shkresën nr. *** akti, datë 7.3.2014). Pra, që në caktimin e seancës duket se është tejkaluar afati i përcaktuar në nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe duket se nuk qëndron pretendimi i subjektit *"...kjo është koha që është dashur për të njoftuar palët për seancën gjyqësore..."*.

x. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime, pasi dukej se në caktimin e seancës gjyqësore për këtë çështje kishte vepruar në kundërshtim me nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale.

xi. Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar në prapësime se në vlerësimin e tij në lidhje me afatin e caktimit të seancës së parë të atij gjykimi ka pasur parasysh nenin 342/4 të Kodit të Procedurës Penale, titulluar "Gjykimi i pandërprerë" (shtuar pika 4 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në fund të pikës 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017), i cili parashikon: *"4. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se tre nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para."* Subjekti ka theksuar se duke konsideruar se "gjykimi fillon nga e para", në lidhje me njoftimet i është referuar nenit 333 të Kodit të Procedurës Penale "Caktimi i seancës", i cili parashikon: *"1. Brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të dëmtuarit akuzues, kryetari i trupit gjykues, i ngarkuar për gjykimin e çështjes cakton, datën e seancës gjyqësore. 2. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën 10 ditë para datës së caktuar për gjykim..."* dhe ndaj ka lënë seancën e parë rreth një muaj nga marrja e akteve për gjykim.

xii. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit në raport me parashikimet e nenit 342 të Kodit të Procedurës Penale, vëren se afati i caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, e cila vijonte nga gjykimi i mëparshëm nga një tjetër subjekt rivlerësimi, nën argumentin e njohjes së trupit gjykues me çështjen, është në përputhje me dispozitën përkatëse. Në kushtet kur subjekti qartëson se përveç njohjes me dosjen kërkohet kohë e nevojshme edhe për përfaqësuesin e organit të akuzës për të marrë dijeni për datën e seancës, shpjegimet e subjektit qëndrojnë dhe duken bindëse në tërësinë e zbatimit të nenit 342 të Kodit të Procedurës Penale. Për rrjedhojë, nuk konstatohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

xiii. Subjekti, në lidhje me ankesën nr. *** prot., datë 9.12.2014, me ankues P.P, ka deklaruar se fillimisht është njoftuar për ankesën, por pastaj nuk është pyetur dhe se nuk i është njoftuar asgjë në lidhje me konkluzionet e verifikimit.

xiv. Subjekti ka theksuar se në lidhje me këtë ankim nuk rezulton të ketë një vendimmarrje të KLD-së ndaj tij dhe se është vetëm një komunikim i kryeinspektores me ankuesin, me objekt “Kthim përgjigje”, datë 9.12.2014.

xv. Subjekti ka sqaruar edhe në lidhje me kthim përgjigjen e dhënë ankuesit. Ai ka sqaruar se kryesisht seancat janë shtyrë për mosformim të trupës gjyquese, megjithëse prej tij në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar ky plotësim pranë drejtuesit të gjykatës. Subjekti ka ricituar përmbajtjen e kthim përgjigjes dhënë ankuesit, ku konfirmohet si vijon: *“Lidhur me pretendimin për zvarritje të gjykimit të çështjes së themelit, e cila është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se çështja penale në ngarkim të të pandehurve SH.LL, P.P, F.D, i ka kaluar me shortin e datës 3.3.2014 trupit gjyqes me kryesues Lazër Sallaku dhe anëtarë R.M dhe T (M) L. Por, në datën 24.3.2014, gjyqtarja T (M) L ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi dhe çështja me rishortim i ka kaluar për gjykim gjyqtarit G.H. Me vendimin nr. ***, datë 2.4.2014, u vendos shpallja e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimi i akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga verifikimi nuk u konstatua zvarritje e gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi të gjitha veprimet procedurale janë kryer brenda afateve. Kërkesa e prokurorit është depozituar në datën 28.2.2014 dhe brenda 7 ditëve gjyqtari Lazër Sallaku ka caktuar zhvillimin e seancës së datës 2.4.2014, konform afatit ligjor, i cili është 10 ditë nga dita e depozitimit të kërkesës. Gjithashtu, kërkesa për përjashtim, vendimi përkatës miratues dhe shorti në vijim janë veprime procedurale të kryera përpara datës së seancës së parë gjyqësore, me qëllim moszvarritjen e gjykimit. Për sa më lart, pretendimet për zvarritje të gjykimit në çështjen konkrete nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk rezultuan të bazuara dhe referuar nenit 33/1/a të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” çmohet arkivimi i këtij pretendimi”. Gjithashtu: “Nga verifikimi rezulton se kërkesa me objekt “Konstatim dhe pavlefshmëri të veprimeve hetimore”, e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u mor në gjykim nga gjyqtari Lazër Sallaku. Nga zhvillimi i seancës së parë gjyqësore deri në dhënien e vendimit gjykimi ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 6 ditë. Nga kjo periudhë, afati i cili i atribuohet me përgjegjësi gjykatës është tejkalimi prej 2 muaj e 17 ditë. Sa më sipër, referuar vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, si dhe pikës 5, germa “j” e Aneksit nr. 1, kjo shkelje do t’i mbahet në konsideratë për efekt vlerësimi profesional dhe etik gjyqtarit kryesues Lazër Sallaku, si i vetmi gjyqtar prezent gjatë të gjithë gjykimit. Ndërsa për gjyqtarët e tjerë çmohet arkivimi i rastit të verifikuar”.*

xvi. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e KLD-së, duke sqaruar se, sikurse është konstatuar, ai ka qenë prezent i vetëm gjatë procesit gjyqësor si pasojë e mosformimit të trupës gjyquese, pra duke shtyrë seancat për këtë shkak, shkak për të cilin i ka bërë në mënyrë të vazhdueshme kërkesë drejtuesit të gjykatës për të plotësuar trupën gjyquese.

xvii. Subjekti ka theksuar se ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për mos të zvarritur gjykimin, pasi në mënyrë permanente i ka kërkuar drejtuesit të gjykatës të plotësojë trupën gjyquese.

xviii. Subjekti ka kundërshtuar vlerësimin e kryeinspektores se kjo shkelje do t’i mbahet në konsideratë për efekt vlerësimi profesional dhe etik gjyqtarit Lazër Sallaku, pasi seancat nuk janë shtyrë për shkak të tij dhe që, për pasojë, sipas subjektit, konstatimi i kryeinspektores është i pasaktë dhe alogjik.

xix. Nga verifikimi i akteve, trupi gjyqes konstatoi se konfirmohen shkaqet e shtyrjes së seancave dhe kërkimet e herëpashershme të subjektit të rivlerësimit drejtuar drejtuesit të gjykatës për plotësim të trupës gjyquese, si dhe kërkesat e palëve ndërgjyqëse për përjashtim të anëtarëve të trupës gjyquese apo edhe kërkesat e tyre (të anëtarëve të tjerë përveç subjektit) për dhënie dorëheqje nga gjykimi i çështjes dhe, për rrjedhojë, nuk konstatoi problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

xx. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionet e KLD-së dhe, për sa kohë deklaroi ai, po ky institucion në vitin 2014, me vendimin nr. ***, datë 14.10.2015, e ka vlerësuar “shumë mirë” për periudhën janar – dhjetor 2014 dhe në këtë kontekst thekson se konstatimet e kryeinspektores nuk kanë pasur peshë në vlerësimin e tij etik dhe profesional. Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 14.10.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sipas këtij vendimi, rezultoi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit me procedurë të përsheptuar, për periudhën kohore janar – dhjetor 2014, “shumë mirë”.

xxi. Një ankesë e vitit 2015, e cila është informacion i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është verifikuar për shkelje të etikës dhe i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor (masa e propozuar “Vërejte me paralajmërim” është rrëzuar nga ish-Këshilli).

xxii. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Lazër Sallaku rezultoi që është paraqitur një kërkesë nga ministri i Drejtësisë, me nr. *** prot., datë 6.1.2016 (regjistruar pranë ish-KLD-së me nr. *** prot., datë 6.1.2016) “Vërejtje me paralajmërim”, kërkesë e shqyrtuar në mbledhjen e ish-Këshillit datë 24.3.2017, ku me vendimin nr. ***, datë 24.3.2017, masa e propozuar është rrëzuar dhe nuk është propozuar masë tjetër disiplinore.

33. Analiza e gjetjeve të raportit të vlerësimit profesional

Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ.

33.1 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Lazër Sallaku, ka shfaqur aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari Lazër Sallaku ka gjykuar vetëm çështje penale, për shkak se ka punuar vetëm në Dhomën Penale.

Konstatohet se gjyqtari manifeston njohuritë e duhura në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale dhe, përgjithësisht, respekton kriteret e nenit 47 të Kodit Penal në caktimin e llojit e masës së dënimit ndaj të pandehurit kur provohet fajësia e tij. Gjithashtu, në të drejtën penale njeh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim. Në një rast kur u provua se i pandehuri ishte i papërgjegjshëm, gjyqtari aplikoi ndaj tij masë mjekësore, e konkretisht “Shtrim i detyruar në një spital psikiatrik i të pandehurit”.

Në të drejtën procedurale penale, gjyqtari respekton të drejtën e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës në gjykim kur kërkohet nga ky i fundit, njeh dhe zbaton gjykimin e shkurtuar sipas parashikimit të nenit 404 të Kodit të Procedurës Penale. Kur është rasti, gjyqtari përdor edhe referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë në zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me aplikimin e gjykimit të shkurtuar.

Gjyqtari njeh dhe zbaton ndaj të dënuarve me burgim kërkesat e ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe detyrat e të dënuarve me burgim”.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 4 prej tyre, ku në dy raste vendimi i dhënë nga gjyqtari Lazër Sallaku është lënë plotësisht në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe në dy raste vendimi u cenua nga kjo Gjykata e Apelit. Në rastin e dokumentit nr. 1, vendimi u cenua pjesërisht vetëm për masën e dënimit për njërin nga të pandehurit dhe për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për dy të pandehur. Vendimi u cilësua i drejtë për pjesët e tjera. Vendimi që i përket dosjes nr. 1 u prish nga Gjykata e Apelit për shkak të miratimit të ligjit të amnistisë. Në këtë rast, vendimi është

prishur për efekt të ligjit, pra për shkaqe që nuk lidhen me zgjidhjen e çështjes nga gjyqtari i shkallës së parë. Si rezultat, vendimi i dosjes nr. 1 nuk quhet i cenuar. Katër vendime kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku shfaq aftësi të mira në drejtim të arsyetimit të vendimeve të dhëna prej tij dhe që kanë qenë objekt vëzhgimi për efekt të rivlerësimit kalimtar. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta e të kuptueshme. Shqyrton dhe analizon provat duke treguar se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, pasi i jepet përgjigje ligjore pretendimeve të palëve. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Mund të thuhet se niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

33.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit Lazër Sallaku, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 19.12.2013, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa nga data 20.12.2013 deri në datën 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ai ka deklaruar se gjatë periudhës 8.10.2013 – 8.10.2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 1042 çështje, ku ka përfunduar 844 prej tyre, duke mbartur në vitin 2017 gjithsej 59 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 80,99%. Për shkak të periudhës së shkurtër kohore, vetëm dy muaj, bazuar në vendimin nr. ***, datë 22.9.2017, të KLD-së “Rregullat për përzgjedhjen me short të pesë dosjeve...”, gjyqtari Lazër Sallaku nuk iu nënshtrua shortimit për çështjet e gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në periudhën 8.10.2013 – 20.12.2013. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2019, konstatohet se për periudhën 8.10.2013 – 20.12.2013 gjyqtari Lazër Sallaku ka gjykuar gjithsej 55 çështje, të gjitha të natyrës penale. Nga ky numër, 31 janë penale themeli, 17 janë kërkesa penale dhe 7 të tjera janë masa sigurimi.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 20.12.2013 – 8.10.2016 gjyqtari Lazër Sallaku ka përfunduar së gjykuari 772 çështje. Nga ky total, 555 janë çështje penale themeli (krime + kundërvajtje), 197 janë kërkesa penale dhe 18 janë çështje penale (masa sigurimi + me të dëmtuar akuzues).

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se gjyqtari Lazër Sallaku, gjatë periudhës 8.10.2013 – 8.10.2016, ka punuar vetëm në dhomën penale. Referuar nenit 3, shkronja “a” e Aneksit 1, gjyqtari i dhomës penale si relator duhet të gjykojë jo më pak se 100 gjykime penale (krime + kundërvajtje penale). Si rezultat, për 3 vjet duhet të gjykojë jo më pak se 300 çështje penale (krime + kundërvajtje). Ndërkohë rezulton se gjyqtari Lazër Sallaku, duke përfshirë punën e kryer prej tij në të dy gjykatat e sipërpërmendura (Durrës dhe Tiranë), për 3 vjet ka përfunduar së gjykuari 586 çështje penale (krime + kundërvajtje). Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe tejkaluar standardin sasior të përcaktuar në Sistemin e Vlerësimit. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Lazër Sallaku ka qenë në intervale kohore nga 25 ditë deri në 2 muaj e 13 ditë. Në 3 dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj e 11 ditë; 1 muaj e 24 ditë; dhe një muaj e 13 ditë. Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit. Gjithashtu, afati standard i gjykimit është respektuar edhe në të tria dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë

e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Lazër Sallaku janë paraqitur 7 ankesa (2 në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Tri ankesa (1 e vitit 2015 dhe 2 të vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi pretendimet respektive për ligjshmëri vendimi zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Katër ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon: tre ankesa (2 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015), verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, ndër të cilat për 1 ankesë është sugjeruar evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional i shkeljes, për 1 tjetër nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari dhe për 1 ankesë është sugjeruar tërheqje vëmendje me shkrim, e cila i mbahet parasysht në vlerësimin etik e profesional. Një ankesë e vitit 2015, e cila është informacion i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është verifikuar për shkelje të etikës dhe i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor (masa e propozuar “Vërejte me paralajmërim” është rrëzuar nga ish-Këshilli). Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku përgjithësisht është eficient dhe efektiv në çështjet që ai ka shqyrtuar. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore në 5 dosjet e vëzhguara. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore.

Në 5 çështjet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar me 4 seanca, me 3 seanca dhe me 1 seancë. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 12 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 3 seanca kanë qenë joproduktive. Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre. Gjithashtu, në procesverbal është shënuar ora e fillimit apo e mbylljes së seancës gjyqësore. Për t’u vlerësuar është fakti që 11 nga 12 seancat gjyqësore të vëzhguara janë regjistruar në audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit të gjyqimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, kërkesa për gjykim bashkë me fashikullin hetimor në dosjet penale, vendimet për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, fletëthirrjet, vendimi përfundimtar, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

33.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtari Lazër Sallaku ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 25.3.1994. Pas studimeve, me vendimin nr. ***, datë 24.11.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. ***, datë 1.7.1994, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Sallaku është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Me vendimin nr. ***, datë 25.5.1999, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtari Sallaku është shkarkuar nga detyra për arsye të mosparaqitjes në provimin e kualifikimit personal. Më pas z. Sallaku është rifutur në sistemin gjyqësor, duke u emëruar inspektor në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me

vendimin e këtij të fundit nr. ***, datë 17.12.2007. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6493, datë 5.4.2010, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Me vendimin nr. ***, datë 20.12.2013, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore rezultoi se në Këshillin e Lartë të Drejtësisë në vitin 2015 është depozituar një ankesë për veprimtarinë e gjyqtarit Lazër Sallaku. Ishte një informacion i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është verifikuar nga Inspektorati i KLD-së për shkelje të etikës dhe në përfundim të inspektimit i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit. Ministri i Drejtësisë, si i vetmi autoritet që fillonte procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve në atë periudhë, i ka kërkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit Lazër Sallaku, duke propozuar ndaj tij masën disiplinore “Vërejte me paralajmërim”. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së ministrit të Drejtësisë, me vendimin nr. ***, datë 24.3.2017, nuk e ka pranuar masën disiplinore të propozuar nga ministri.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Lazër Sallaku. Për vetë gjyqtarin Lazër Sallaku, në asnjë nga 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa nga ndonjë palë për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të tria dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

33.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Lazër Sallaku komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore. Në të tria dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarit Lazër Sallaku për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste të shpeshta që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, gjë që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

C/1. Rivlerësimi profesional

34. Nga analizimi i të gjitha dokumenteve ligjore të administruara dhe dosjeve gjyqësore të përfunduara nga subjekti i rivlerësimit, pas analizimit të të cilave është përgatitur edhe raporti përkatës, duket se nuk vërehen problematika në lidhje me rivlerësimin e këtij kriteri.

34.1 Nga korrespondenca e mbajtur me SPAK-un⁷⁵ rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit:

a. Nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

- Konfirmohet se ka pasur material kallëzues nga shtetasi K.L, ku pas kryerjes së verifikimeve është vendosur dërgimi i tij për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Nga korrespondenca e mbajtur me ILD-në⁷⁶ rezulton se z. L është ankuar për shkelje të kryera nga një prokurore dhe subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në procedimin penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ILD-ja, me vendimin nr. *** prot., datë 30.1.2022, ka vendosur arkivimin e ankesës së z. L, duke i njoftuar njëkohësisht edhe palëve vendimin përkatës me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2022, si dhe të drejtën e ushtrimit të ankimit ankuesit K.L.

- Konfirmohet se ka pasur material kallëzues nga shtetasi R.K, ku pas kryerjes së verifikimeve është vendosur përcjellja e materialit kallëzues për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

b. Në lidhje me këtë kallëzim, Komisioni administroi⁷⁷ fashikullin penal, që i përket procedimit penal nr. ***. Nga aktet e fashikullit rezultoi se shtetasi R.K ka kallëzuar disa pushtetarë të kohës, nën akuzat “shpërdorim detyre”, “shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, “mashttrim”, “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 143, 245/1, 248, 258 dhe 287 të Kodit Penal. Me vendimin datë 24.1.2020, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kallëzuesit *** dhe shtetasi R.K, është kërkuar “*Pushimi i procedimit penal nr. ***, datë 19.9.2017*”. Në datën 24.1.2020, gjykata/subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesën e organit të akuzës sipas objektit të saj “Pushimi i procedimit penal”. Sipas vendimit, rezulton se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Kuvendi dhe shtetasi R.K kanë kërkuar kthimin e çështjes për vijimin e hetimeve, me qëllim pyetjen e disa shtetasve dhe hetimin për veprën penale “shpërdorim detyre” për disa ish-funksionarë. Kallëzuesi në kallëzimin e tij drejtuar SPAK-ut pretendon⁷⁸ se gjyqtari/subjekti i rivlerësimit ka shpërdoruar detyrën, ka rrëzuar padrejtësisht kërkesën për të shpallur moskompetencën, ka bërë qëllimisht cilësim të mangët juridik dhe ka pushuar në mënyrë të padrejtë çështjen penale që lidhet me privatizimin e OSSH-së nga shoqëria CEZ. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi kallëzimin e shtetasit R.K/denoncuesit për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre” nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin e saj datë 9.3.2020, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal nr. ***, ndaj subjektit të rivlerësimit. Ndër të tjera, në vendim konfirmohet se vendimi gjyqësor i subjektit të rivlerësimit (me të cilin ishte vendosur “Pushimi i procedimit penal”) është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, çka nënkupton se gjykata më e lartë kontrollon ligjshmërinë e gjykatës më të ulët. Ndërkohë, në vendimin e mosfillimit arsyetohet se nga shqyrtimi i materialit kallëzues nuk ekziston asnjë e dhënë apo fakt që gjyqtari i kallëzuar të ketë pasur ndonjë interes vetjak në gjykimin e kësaj çështjeje penale, për më tepër që vendimi të jetë dhënë në keqbesim.

⁷⁵ Referuar përgjigjes së këtij institucioni, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁶ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 6.2.2023 dhe materialit bashkëngjitur saj, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁸ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 26.2.2020, administruar në fashikullin penal të përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

34.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime të detajuara në lidhje me pretendimet e denoncuesit/kallëzuesit, se: (i) kishte rrëzuar padrejtësisht kërkesën për të shpallur moskompetencën; (ii) kishte bërë qëllimisht cilësim të mangët juridik; (iii) kishte pushuar në mënyrë të padrejtë çështjen penale që lidhej me privatizimin e OSSH-së nga shoqëria CEZ; (iv) të depozitonte kopje të plotë të dosjes, që i përket vendimit datë 24.1.2020, dhënë prej tij, për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 19.9.2017; (v) të qartësonte dhe dokumentonte deri aktualisht statusin e vendimit⁷⁹ të dhënë prej tij, me të cilin është vendosur “Pushimi i procedimit penal nr. ***, datë 19.9.2017”; (vi) të qartësonte dhe të dokumentonte deri aktualisht statusin e vendimit datë 9.3.2020, me të cilin ishte vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”, për kallëzimin penal ndaj subjektit të rivlerësimit, nr. ***.

34.3 Subjekti, ndër të tjera, në prapësimet e tij në lidhje me çështjen e kompetencës, ka shpjeguar se çështja CEZ ka nisur përpara krijimit dhe funksionimit të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar në dhjetor 2019. Subjekti ka qartësuar se për çështjet e filluara përpara funksionimit të kësaj gjykate vendimi njësuës i Gjykatës së Lartë nr. 13, datë 4.4.2018, kishte vendosur vijueshmërinë e tyre në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm. Subjekti ka sqaruar se për këtë çështje, megjithëse organi i akuzës kishte kërkuar pushimin, ai e kishte kthyer atë për të vijuar me hetimet dhe për këtë subjekti ka renditur në prapësime me përpikëri të gjithë detyrat e lëna për t’u përmbushur nga organi i akuzës. Subjekti ka sqaruar se edhe pas kryerjes së hetimeve sërish nga organi i akuzës është kërkuar pushimi i çështjes për veprat penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale”, të parashikuara nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal dhe se pas vendimmarrjes së subjektit ka pasur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e subjektit. Subjekti ka deklaruar se aktualisht çështja është në Gjykatën e Lartë. Subjekti ka shpjeguar se ai ka administruar 54 volume dhe se është në pamundësi financiare të fotokopjojë këtë material voluminoz. Subjekti ka konfirmuar se edhe ndaj vendimit të mosfillimit për subjektin e rivlerësimit, kallëzuar nga denoncuesi për shpërdorim detyre, nuk është ushtruar ankim.

34.4 Subjekti ka depozituar dy vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht vendimin nr. *** akti, datë 15.12.2017 dhe vendimin nr. 5410/211 akti, datë 24.1.2020; vendimin nr. ***, datë 24.6.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë; një fletë e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë; një printim i vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, ku pasqyrohet administrimi i 54 volumeve të dosjes së prokurorit të administruara në gjykim; njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës së shtetasit R.K, së bashku me vendimin përkatës të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; shkresën nr. *** prot., datë 16.5.2023, të drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, së bashku me vendimin e mosfillimit nr. ***, datë 9.3.2020.

34.5 Trupi gjykues, referuar pretendimit të denoncuesit në raport me shpjegimet e subjektit, konstaton se sipas vendimit njësuës të Gjykatës së Lartë konfirmohet fakti i vijimësisë së procesit gjyqësor nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm, duke mos konstatuar ndonjë problematikë lidhur me çështjen e juridiksionit. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nuk u vërejtën mangësi në gjykimin e çështjes, gjithnjë referuar indikatorëve të vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016 dhe kompetencës së Komisionit për të kryer vlerësime sipas ligjit nr. 84/2016. Në të tilla kushte, nuk diktohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit, shtuar këtu edhe fakti se vendimmarrjet janë kontrolluar nga një gjykatë më e lartë.

34.6 Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka rezultuar se nuk është regjistruar ndonjë procedim

⁷⁹ Nr. *** akti, datë 24.1.2020, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kallëzuesit Kuvendi i Shqipërisë dhe shtetasi R.K, me të cilin është vendosur “Pushimi i procedimit penal nr. ***, datë 19.9.2017”.

penal, por ka rezultuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve, në datën 4.1.2019, është vendosur “Mosfillim i procedimit penal”.

34.7 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të qartësonte dhe dokumentonte deri aktualisht statusin e këtij vendimi.

34.8 Subjekti ka sqaruar se kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018 ndaj tij është depozituar në ish-Prokurorinë për Krime të Rënda nga shtetasi S.S. Ai ka deklaruar se pas verifikimeve në sekretarinë gjyqësore, rezulton se pranë ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është ushtruar ankim nga shtetasi S.S, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë për Krime të Rënda lidhur me mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, viti 2018” dhe në përfundim të gjykimit gjykata ka dhënë vendimin nr. ***, datë 26.2.2019 me anë të të cilit ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës penale me kërkues kallëzuesin S.S”, me objekt “Kundërshtimin (shfuqizimin) e vendimit datë 4.1.2019, të prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë lidhur me mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, viti 2018”*. Subjekti ka deklaruar se vendimi i sipërcituar është ankimuar nga shtetasi S.S dhe rezulton se nga ish-Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.4.2019, është vendosur: *“Miratimi i vendimit nr. ***, datë 26.2.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”*. Subjekti ka depozituar fotokopje të njësuar me origjinalin të vendimit nr. ***, datë 26.2.2019, të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, së bashku me shënimet përkatëse çfarë ka vendosur Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Gjithashtu, subjekti ka informuar se vendimi nr. ***, datë 4.4.2019, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është rekursuar nga pala kërkuese S.S dhe aktualisht dosja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

34.9 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, nuk konkludoi në ndonjë fakt apo rrethanë që të përbëjë shkak për cenimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

34.10 Këshilli i Lartë Gjyqësor⁸⁰ ka konfirmuar se nga regjistri statistikor me të dhëna mbi procedimet disiplinore rezulton se ka pasur një kërkesë për procedim nga Ministri i Drejtësisë me nr.*** prot, datë 06.01.2016 për “Vërejtje me paralajmërim”, kërkesë e cila sipas informacionit të këtij institucioni është shqyrtuar në mbledhjen e ish Këshillit datë 24.03.2017, ku me vendimin nr.***, datë 24.03.2017 masa e propozuar është rrëzuar dhe nuk është propozuar masë tjetër disiplinore. Në përmbajtje të materialit vërehet se ankimi është bërë nga bashkëshortja e subjektit në shkurt të vitit 2015 për shkak të një konflikti të ashpër me bashkëshortin. Situata është ndjekur në vijim përmes ballafaqimeve dhe deklarimeve të kolegëve të ndodhur në ambiente të gjykatës në ndodhinë e ngjarjes, nga ku ka rezultuar më pas se ajo i ka tërhequr deklaratimet e saj duke u shprehur se i kishte dhënë ato në kushtet e tronditjes. Çështja është bërë objekt inspektimi për shkak të informacionit të dhënë nga kryetari i gjykatës dhe kërkesës së Ministrit të Drejtësisë drejtuar KLD-së, për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj subjektit të rivlerësimit.-Vendimi ka argumentuar se konstatohen vështirësi në provueshmërinë e sjelljes dhe veprimeve që bien ndesh me etikën e gjyqtarit, të kryera nga gjyqtari Lazër Sallaku dhe për shkak të këtyre rrethanave ka rrëzuar kërkesën e Ministrit të Drejtësisë.

34.11 Prokuroritë e rretheve, përmes Prokurorisë së Përgjithshme⁸¹, kanë konfirmuar si vijon:

a. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë⁸² ka konfirmuar se pranë kësaj Prokurorie është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe se ky procedim është pushuar me vendimin nr. ***, datë 26.12.2018, të Gjykatës së

⁸⁰ Me shkresën nr.*** prot, datë 08.09.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸² Me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 12.6.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë⁸³.

b. Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 26.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, si dhe vendimin nr. ***, datë 12.6.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilin sqaron se është rekursuar dhe se nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton me status “Studim çështjeje”.

c. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁴ ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 21.12.2021, për veprat penale “falsifikim dokumentesh” dhe “moskallëzim krimi”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 300 të Kodit Penal, transferuar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Po nga kjo Prokurori është konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 29.12.2021, për veprat penale “falsifikim dokumentesh” dhe “shpërdorim detyre”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, transferuar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

34.12 Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte dhe dokumentonte deri aktualisht statusin e këtyre kallëzimeve, përfshirë këtu edhe shkallët e gjyqësorit (gjithnjë nëse ka pasur ankime). Në varësi të përgjigjes subjektit iu kërkua të depozitonte edhe vendimet përkatëse.

34.13 Subjekti ka sqaruar në prapësime se të dyja kallëzimet janë regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe janë bashkuar me numrat përkatës të kallëzimit, nr. *** dhe nr. *** dhe për to është marrë vendim mosfillimi me nr. *** nga ana e kësaj Prokurorie. Sipas verifikimeve të kryera në sistemin ICMIS, i cili operon që nga viti 2007 e në vijim, rezulton se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kanë qenë për gjykim çështjet penale, si vijon: çështja penale me nr. (***) *** akti, datë 8.3.2022 regjistrimi, me kërkues F.B kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Kundërshtimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal datë 13.1.2022, për materialin kallëzues nr. ***, nxjerrë nga prokuroria me shkresën nr. *** prot. (***), datë 14.2.2022”, çështje e cila ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.5.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (vendim i cili nuk është i formës së prerë, pasi ndaj tij është ushtruar ankim); çështja penale me nr. (***) *** akti, datë 10.11.2022 regjistrimi, me kërkues F.B kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 13.1.2022, për materialin kallëzues nr. ***, të nxjerrë nga prokuroria me shkresën nr. *** prot. (***), datë 14.2.2022”, çështje e cila ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.11.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (vendim i cili nuk është i formës së prerë, pasi ndaj tij është ushtruar ankim).

34.14 Subjekti ka deklaruar se deri në datën 9.5.2023 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nuk është përcjellë nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ndonjë vendim në lidhje me këto çështje.

34.15 Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 5.5.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe vendimin nr. ***, datë 21.11.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

34.16 Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar, nuk konkludon në ndonjë fakt apo rrethanë që ndikon në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34.17 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁸⁵ konfirmon se ka regjistruar materialin hetimor ndaj subjektit të rivlerësimit, me nr. ***, për të cilin është marrë në datën 27.1.2022 “Vendimi

⁸³ Referuar dosjes penale të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2021.

⁸⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

i mosfillimit të procedimit”. Njëkohësisht, kjo prokurori ka bashkëngjitur edhe materialin hetimor. Nga fashikulli penal vërehet se shtetasi F.B ka kallëzuar disa gjyqtarë pranë SPAK-ut, nën akuzën e shpërdorimit të detyrës dhe moskallëzimit të krimit, pasi prej tij janë pretenduar shkelje të kryera nga gjyqtarët që kanë gjykuar këtë çështje pas dërgimit të kërkesës së organit të akuzës. Kallëzimi ndaj gjyqtarëve parashtrohet nën argumentin se ata nuk kanë referuar/kallëzuar pranë organit të prokurorisë aktet e falsifikuara të pretenduara prej denoncuesit se janë përdorur në dosjet hetimore apo gjyqësore, se nuk kanë pranuar kërkesën për refuzimin e masës “arrest me burg” dhënë ndaj tij, se kanë refuzuar të shqyrtojnë prova thelbësore gjatë seancës për revokimin e masës së arrestit, etj. Çështjen penale e ka ndjekur Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendimin e saj datë 27.1.2022, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”.

34.18 Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte dhe dokumentonte deri aktualisht statusin e vendimit të “Mosfillimit të procedimit penal”.

34.19 Subjekti ka sqaruar në prapësime se çështja objekt kërkimi është e njëjtë me çështjen e përshkruar më sipër në pikën 34.11.

34.20 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit dhe përshkrimeve të çështjes në të dyja rastet, konfirmon të njëjtin fakt të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe, në këto kushte, nuk vlerëson të bjerë në përsëritje.

35. Konstatime nga burime të tjera

35.1 Komisioni, nga informacioni i disponuar nga të tjera autoritete ligjzbatuese, si dhe nga të dhënat e sistemit TIMS për shtetasen A.S (S), ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se ndaj saj është caktuar urdhër mbrojtjeje, për shkak të dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar nga shtetasi Lazër Sallaku.

35.2 Komisioni⁸⁶ administroi praktikën gjyqësore, ku nga verifikimi i akteve rezultoi si vijon:

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është dërguar për gjykim kërkesëpadia me paditëse A.S (S), i paditur subjekti i rivlerësimit, me objekt padie “Lëshim urdhri i menjëhershëm mbrojtjeje”. Çështja gjyqësore është pushuar me vendimin nr.***, datë 29.05.2015, bazuar në kërkesën e paditëses e cila jashtëgjyqësisht kishte kërkuar pushimin e gjykimit për shkak se kishte normalizuar marrëdhëniet me të paditurin. Çështja gjyqësore e ka pasur zanafillën mbi ankimin e znj. S (S)/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, e cila në padinë e paraqitur në datë 26.03.2015, për Lëshim të Urdhërit të Mbrojtjes (plotësuar nga Komisariati nr.*** në Tiranë), ka paditur subjektin e rivlerësimit/bashkëshortin e saj.

35.3 Nga aktet e administruara rezultoi të jetë vendosur nga OPGJ-ja e Komisarariatit nr. *** Tiranë, në datën 26.3.2015, edhe kryerja e ekspertimit mjekoligjor ndaj znj. A.S, vendim i cili nuk është zbatuar. Duket se nuk është realizuar. Vërehet se çështja fillimisht është adresuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga ku është vendosur moskompetenca e saj për gjykim në këtë gjykatë dhe kalimi i akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sikurse u theksua më sipër, ka vendosur pushimin e saj.

35.4 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se dukej se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit ndaj ish-bashkëshortes cenojnë etikën dhe figurën e magjistratit dhe bien ndesh me parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore, miratuar me vendimin nr. ***, datë 22.4.2021, të KLGJ-së, si dhe Parimet e Bangalores dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit⁸⁷ të jepte shpjegime.

35.5 Subjekti i rivlerësimit në prapsimet e tij ka sqaruar gjerësisht këtë çështje. Subjekti ka mohuar që ajo të jetë dhunuar nga ana fizike. Subjekti ka qartësuar se të paktën gjykon tre çështje në javë për veprën

⁸⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

penale të “Dhunës në familje” dhe se i njeh shumë mirë pasojat që vijnë nga ushtrimi i dhunës ndaj familjarëve.

35.6 Subjekti ka deklaruar se nuk është e vërtetë që ish-bashkëshortja nuk ka shkuar tek eksperti mjekoligjor, sipas vendimit të OPGJ-së së Komisarariatit nr. *** Tiranë, z. A.M, në datën 26.3.2015. Ai ka konfirmuar se ajo ka shkuar dhe është kryer akti nr. *** “Mbi ekspertimin e shtetases A.S”, datë 27.3.2015, hartuar nga eksperti mjekoligjor, dr. A.K, i cili ka konkluduar se: “*Në trupin e shtetases A.S nuk konstatohen dëmtime të jashtme*”. Subjekti ka mohuar që të ketë ushtruar ndonjëherë dhunë nga ana e tij ndaj saj dhe, në këtë kontekst, ka theksuar se *prandaj ajo nuk kishte asnjë provë për të kundërtën*.

35.7 Po ashtu, subjekti ka deklaruar se ish-bashkëshortja nuk ka bërë kallëzim, pasi nuk kishte prova për të kundërtën, pasi kishte njohuri se kallëzimi i rremë është vepër penale. Gjithashtu, ai ka konfirmuar një lidhje tjetër të saj në të njëjtën kohë dhe ndaj, ka shtuar subjekti, ajo ka sajuar skenarin për t’i dhënë fund martesës. Në përfundim, subjekti ka deklaruar se: “*...nuk ka asnjë provë, asnjë fakt apo indicie të kem ushtruar dhunë ndaj ish-bashkëshortes time*”.

35.8 Subjekti ka depozituar një fotokopje të vendimit nr. ***, datë 27.3.2015, të aktit të ekspertimit mjekoligjor.

35.9 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna, në analizë të dokumentacionit të administruar, konstatoi se: (i) ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk ka munguar t’i nënshtrohet aktit të ekspertimit mjekoligjor, i cili ka konkluduar pa probleme dhe nuk është depozituar në dosjen gjyqësore; (ii) ajo është tërhequr nga gjykimi i padisë me objekt “Lëshim urdhri i menjëhershëm mbrojtjeje”; (iii) ajo rezultoi se është tërhequr edhe në një situatë të mëparshme konfliktuale të ndodhur në ambientet e gjykatës, sikundër është përshkruar në pikën 18.2, nën argumentin se i kishte dhënë ato/deklarimet në kushtet e tronditjes, çmon se në këtë çështje objekt vlerësimi nuk u arrit të provohej ndonjë veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit ndaj ish-bashkëshortes së tij, në kundërshtim me rregullat e etikës dhe figurës së magjistratit, miratuar me vendimin nr. ***, datë 22.4.2021, të KLGJ-së, si dhe Parimet e Bangalores.

Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016

36. Denoncim⁸⁸ i shtetases A.M

36.1 Denoncuesja ankohet thajse për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndër të tjera, për subjektin e rivlerësimit pretendon për shkelje të kryera prej tij në një kërkesë të gjykuar me objekt “Caktim i masës së sigurimit personal ndaj shtetasit sirian M.M”, akuzuar për veprën penale “përdorim të dokumentit të falsifikuar”, parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal, çështje të cilën e ka përfaqësuar në cilësinë e avokates. Denoncuesja ankohet për zvarritje të qëllimshme të gjykimit, për marrje me vonesë të vendimit të urdhrimit të ekzekutimit, për shkak të përfundimit të dënimit pasi ishin llogaritur afatet e paraburgimit.

36.2 Komisioni⁸⁹ administroi kopje të dosjes gjyqësore. Nga aktet e administruara u konstatua se shtetasi M. është arrestuar në flagrancë dhe për të është caktuar masa e sigurimit “arrest me burg” në shtator të vitit 2021, pasi është konstatuar nga autoritetet vendase se udhëtonte me dokument të falsifikuar. Më tej, shtetasi sirian M., i përfaqësuar nga avokatja M., ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit dhe pas heqjes dorë nga kjo kërkesë gjykata/subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Pushimin e gjykimit. Nga aktet rezultoi se shtetasi M, me vendimin nr. ***, datë 18.1.2022 (dhënë nga subjekti i rivlerësimit) është dënuar me 6 muaj burgim, nën akuzën “falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave, dhe i vizave”, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal, sikurse kishte kërkuar edhe organi i akuzës. Në vijim,

⁸⁸ Nr. *** prot., datë 16.3.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

mbrojtësi i të pandehurit ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit për shkak të plotësimit të afatit të burgimit nëpërmjet qëndrimit në paraburgim. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e tij, datë 28.1.2022, ka vendosur “Shuarjen e masës së sigurimit arrest me burg, urdhërimin e lirimit të menjëhershëm të të dënuarit, si dhe detyrimin e ekzekutimit të vendimit organit të akuzës”, për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar.

36.3 Komisionit, nga verifikimi i kohëzgjatjes së shqyrtimit dhe dhënies së vendimeve, nuk i rezultoi ndonjë problematikë. Po ashtu, nga aktet e administruara, si referuar njoftimeve dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore, nuk rezultuan veprime procedurale të pa kryera nga ana e gjykatës.

36.4 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

37. Denoncim⁹⁰ i shtetases K.Q

37.1 Denoncuesja ankohet për vendimmarrje të gabuar nga subjekti i rivlerësimit, marrë në shkelje të ligjit, duke vendosur pushimin e gjykimit për të akuzuarin, edhe pse hetimi dhe përgjithësisht organi i akuzës kishin qenë pro tij. Denoncuesja ankohet se i pandehuri nuk është përfaqësuar me avokat deri në dy seancat e fundit të procesit dhe më tej, duke qenë se është përfaqësuar nga avokati, asaj i kanë lindur dyshime për korrupsion pasiv.

37.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar po nga denoncuesja, rezultoi se me vendimin e datës 14.11.2017 organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprat penale “kanosje” dhe “dëmtime të tjera me dashje”, iniciuar nga kallëzimi i shtetases Q.

37.3 Më tej, denoncuesja është ankuar në gjykatë lidhur me këtë çështje, nga ku, me vendimin nr. ***, datë 6.6.2018, është vendosur deklarimi i pafajshëm i të akuzuarit. Nga aktet e administruara vërehet se denoncuesja ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

37.4 Komisioni i kërkoi subjektit⁹¹ të qartësojë dhe të dokumentojë statusin e vendimit të gjykatës nr. ***, datë 6.6.2018, me viktimë akuzuese shtetases K.Q.

37.5 Subjekti ka shpjeguar se vendimi i dhënë prej tij me nr. ***, datë 6.6.2018, me viktimë akuzuese shtetaset K.Q dhe DH.Q, të akuzuar M.A, akuzuar për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje” parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, është ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe është regjistruar pranë kësaj Gjykate si çështja penale me nr. *** regj., datë regjistrimi 13.4.2022. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 14.4.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

37.6 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se ankesa ka të bëjë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

38. Denoncim⁹² i shtetases M.R

38.1 Denoncuesja ankohet për vendimmarrje të padrejtë të subjektit të rivlerësimit, marrë në shkelje të ligjit procedural dhe material për shkak të paaftësisë apo marrjes së rryshfetit. Denoncuesja sqaron se çështja i referohet një kallëzimi të bërë prej saj në organin e akuzës për shkak se është dhunuar psikologjikisht nga administratori i shoqërisë ku ajo punonte. Mbi kërkesën e organit të akuzës për pushimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 12.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë. Denoncuesja ka sqaruar se ka

⁹⁰ Nr. *** prot., datë 17.10.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹¹ Me pyetësorin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹² Nr. *** prot., datë 3.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

ankimuar vendimin gjyqësor, por edhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur me vendimin e saj nr. ***, datë 4.2.2019, lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se çështja është rekursuar nga denoncuesja.

38.2 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se ankesa ka të bëjë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

39. Denoncim⁹³ i shtetases A.N

39.1 Denoncuesja ankohet për vendimmarrje të padrejtë të marrë nga subjekti i rivlerësimit për çështjen penale në ngarkim të një shtetaseje të akuzuar për kryerjen e veprës penale të pornografisë. Denoncuesja denoncon subjektin, në cilësinë e nënës së njëres prej viktimave të kësaj vepre penale. Denoncuesja ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit, nën pretendimin se ai ka gjykuar provat sikur të ishte gjyqtar i themelit dhe jo i seancës paraprake.

39.2 Nga verifikimi i parashtrimeve në denoncim dhe nga vendimi gjyqësor i cili është depozituar së bashku me ankimin nuk qartësohet lidhja midis denoncueses dhe ndonjëres prej palëve në proces. Gjykata, me vendimin e saj datë 18.3.2019, mbi kërkesën e organit të akuzës për dërgimin në gjyq të çështjes nr. ***, me të pandehur shtetasen D.T, e akuzuar për kryerjen e veprës penale “pornografi”, parashikuar nga neni 117/3 i Kodit Penal, në dy raste ka vendosur “Pushimin e çështjes penale” në ngarkim të të pandehurës D.T, për veprën penale “pornografi”, parashikuar nga neni 117/3 i Kodit Penal, konsumuar dy herë në dëm të viktimave.

39.3 Komisioni i kërkoi subjektit⁹⁴ të qartësojë dhe të dokumentojë deri aktualisht statusin e vendimit gjyqësor, datë 18.3.2019, me të pandehur shtetasen D.T, e akuzuar për kryerjen e veprës penale “pornografi”, parashikuar nga neni 117/3 i Kodit Penal, në dy raste.

39.4 Subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor datë 18.3.2019, me të pandehur shtetasen D.T, e akuzuar për kryerjen e veprës penale “pornografi”, parashikuar nga neni 117/3 i Kodit Penal, në dy raste ka marrë formë të prerë, pasi Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 20.10.2019, ka vendosur “Mospranimin e ankimit për shkak të heqjes dorë nga prokuroria”.

39.5 Nga trajtimi i këtij denoncimi duket se ankesa ka të bëjë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë, që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

40. Denoncim⁹⁵ i shtetasit R.G

40.1 Denoncuesi (profesor i Historisë dhe i së Drejtës në A.S.A, si dhe ish-****) ankohet për shkelje të etikës nga subjekti i rivlerësimit për shkak të komunikimit të tij me palën. Denoncuesi sqaron se çështja e iniciuar në gjykatë i referohet akuzës së shpifjes, për të cilën ai ka kallëzuar ish-****, të ndjerin N. Denoncuesi, pasi qartëson se ndaj tij janë hedhur akuza të paqena e të pabaza nga i ndjeri, pretendon për komunikim të papërshtatshëm në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit në adresë të tij dhe avokates së tij. Ai pretendon se subjekti i rivlerësimit në gjykimin e çështjes ka marrë prova në tejkallim të objektit të kërkimit gjyqësor, ka devijuar procesin si një përgjigje për persona të tjerë dhe të dhëna që kanë të bëjnë me persona të tjerë, ndërsa objekti i konfliktit ka qenë shpifje publike e realizuar përmes komunikimit publik të z. N. në adresë të denoncuesit. Denoncuesi ka depozituar diskutimet përfundimtare në datën 25.1.2022.

⁹³ Nr. *** prot., datë 6.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁴ Me pyetësorin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁵ Nr. *** prot., datë 27.1.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

40.2 Komisioni administroi⁹⁶ dosjen gjyqësore me nr. 30 akti, ku nga aktet e administruara vërehet se:

a. Çështja është vënë në lëvizje me kërkesë të të dëmtuarit akuzues/denoncuesi, i cili ka akuzuar ish-***, të ndjerin N, për veprën penale “shpifje”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, në kuadër të një akuze të bërë publike prej këtij të fundit lidhur me pozitën e z. G. në të kaluarën, duke e etiketuar me pseudonime të ndryshme si i rekrutuar nga oficerë të sigurimit të asaj kohe. Për përbaltje të figurës, z. G. ka nisur procesin gjyqësor. Nga aktet rezulton se që në seancën e parë z. G. ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga çështja objekt gjykimi, nën argumentet se subjekti i rivlerësimit në kohën që njëkohësisht ka qenë kryetar i KLD-së ka kryer transferimin e subjektit të rivlerësimit nga Durrësi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (në vitin 2013), ka firmosur ngritjen e shkallës ë vlerësimit (në vitin 2014) dhe ka qenë pjesë e një institucioni që ka hedhur poshtë në komisionin disiplinor një kërkesë të ministrit të Drejtësisë së kohës, për gjyqtarin në fjalë (në vitin 2017, për çështjen e trajtuar më sipër si konflikt i prodhuar mes tij dhe ish-bashkëshortes në ambientet e gjykatës ku subjekti ushtronte detyrën). Në kërkesën e përjashtimit janë bërë prezente fakte e rrethana nga denoncuesi lidhur me këto tri argumente, që njëkohësisht i është kërkuar gjykatës të marrë dokumentacionin e plotë mbi të dhënat paraprake të ofruara nga denoncuesi, për shkak të mossigurimit prej tij të të gjithë dokumentacionit të plotë.

b. Seanca e parë e zhvilluar në datën 22.2.2021 është shtyrë, ndër të tjera, për në datën 11.3.2021, edhe për shqyrtimin e kësaj kërkesë nga një tjetër trupë gjyqësore. Po në datën 22.2.2021 është shqyrtuar kërkesa për përjashtim gjyqtari dhe gjykata, me vendimin e kësaj date, ka vendosur “Shpalljen e papranueshme të kërkesës”, duke konfirmuar edhe të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë. Në seancën e radhës subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Pushimin e gjykimit të çështjes”, për shkak të mosparaqitjes së denoncuesit, edhe pse ka pasur dijeni nga seanca e mëparshme.

c. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se nuk vihet re ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

ç. Ndërsa, sa i përket vijueshmërisë së kësaj çështjeje të ngritur rishtazi nga denoncuesi, nga përmbajtje e denoncimit mësohet se përsëri gjyqtari i çështjes ka qenë subjekti i rivlerësimit. Për këtë gjykim, denoncuesi gjithashtu ka ripërsëritur të njëjtat pretendime lidhur me etikën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit. Nga informacioni i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të cilin u administrua dosja e trajtuar më sipër, konfirmohet se çështja nr. ***, datë 26.1.2022, është ankimuar dhe dosja disponohet nga Gjykata e Apelit Tiranë.

40.3 Nga shqyrtimi i këtij rasti, në nivelin që janë provat, vërehet se ankesa përqendrohet kryesisht në shqyrtimin e themelit të çështjes dhe, për rrjedhojë, shqyrtimi i saj nuk është në kompetencë të Komisionit.

Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësojë dhe të dokumentojë deri aktualisht statusin e çështjes me nr. ***, datë 26.1.2022 (gjithnjë nëse kishte përfunduar gjykimi në Gjykatën e Apelit e në vijim).

40.4 Subjekti sqaroi⁹⁷ se statusi i çështjes me nr. ***, datë 26.1.2022, i ankimuar nga denoncuesi, është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin e saj të datës 14.9.2022, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 26.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes penale me viktimitë akuzuese z. R.G dhe të akuzuar z. B.N, për shkak se i akuzuari ka ndërruar jetë.

40.5 Subjekti, për të vërtetuar këtë fakt, ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 22.5.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

⁹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.4.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁷ Me email-in datë 22.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

40.6 Trupi gjykues, nga shqyrtimi i këtij denoncimi, nuk vëren fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

41. Denoncim⁹⁸ i shtetasit Z.K

41.1 Denoncuesi, si ortak i vetëm i shoqërisë ndërtuese “D” sh.p.k., ankohet ndaj vendimit nr. *** akti, datë 28.6.2019, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me të cilin është vendosur “Mospranimi i kërkesës ankimore ndaj vendimit të organit të akuzës për mosfillimin e procedimit penal”. Denoncuesi ankohet se në dosjen gjyqësore të një procesi civil të zhvilluar mes kësaj shoqërie dhe shtetasit V.N, e ndodhur në Gjykatën e Lartë, janë administruar dokumente fotokopje të paqena në origjinal, të falsifikuara nga avokatë dhe noterë të cilët kanë qenë objekt i kallëzimit të tij në organin e akuzës. Denoncuesi ka depozituar kallëzimin datë 15.2.2019, vendimet përkatëse të organit të akuzës, si dhe vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, datë 28.6.2019.

41.2 Nga dokumentacioni i administruar vërehet se subjekti i rivlerësimit me vendimin e tij ka vendosur “Mospranimin e ankimit ndaj vendimit të organit të akuzës, datë 6.3.2019”, me të cilin ishte vendosur “Mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 20.2.2019”.

41.3 Komisioni i kërkoi subjektit⁹⁹ të qartësojë dhe të dokumentojë deri aktualisht statusin e çështjes gjyqësore që i përket vendimit nr. *** akti, datë 28.6.2019, çështje e vënë në lëvizje bazuar në ankimin e ortakut të vetëm të shoqërisë ndërtuese “D” sh.p.k., z. Z.K.

41.4 Subjekti ka shpjeguar se çështja gjyqësore që i përket vendimit nr. *** akti, datë 28.6.2019, është në Gjykatën e Lartë, me status “Studim çështjeje”, si dhe ka depozituar kopje të vendimit nr. ***, datë 2.6.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë, kopje të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe printimin nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë.

41.5 Komisioni, në analizë të pretendimeve të denoncuesit dhe dokumentacionit të administruar, konstatoi se Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur vendimin e subjektit, duke arsyetuar se subjekti: (i) nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e normave procedurale dhe, për pasojë, nuk ka evidentuar detyrat që duhet të kishte kryer organi i akuzës lidhur me këtë çështje, referuar objektit të kallëzimit penal, sipas nenit 186 të Kodit Penal; (ii) ka gabuar në marrjen e vendimit, pasi nuk ka identifikuar mungesën e hetimeve të kryera nga organi i akuzës lidhur me ekzistencën apo jo të faktit penal, ndërsa ka arsyetuar referuar nenit 66 të Kodit Penal se ndjekja penale është parashkruar.

41.6 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte lidhur me këto konstatime.

41.7 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar në prapësime se në rastin e parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal, ligji shprehet qartë se nëse jemi në këto rrethana procedimi penal nuk mund të fillojë, kjo është e parashikuar në nenin 290/1/d të Kodit të Procedurës Penale¹⁰⁰. Subjekti ka shpjeguar se në analizë të dispozitës së parashikuar në nenin 66 të Kodit Penal, objekti i masës së dënimit të parashikuar në këtë nen i referohet maksimumit të dënimit të parashikuar shprehimisht nga secila dispozitë që parashikon veprën penale. Parashikimi i një hapësire dënimi, duke filluar me një cak minimumi dhe një cak maksimumi të masës së dënimit, shërben jo vetëm për përcaktimin dhe individualizimin e sanksionit penal me parimin e fajësisë dhe realizimin e dhënies së drejtësisë, por gjithashtu edhe për përcaktimin e maksimumit të sakrificimit të lirisë personale që mund të caktohet për cenimin e një marrëdhënieje juridike të mbrojtur penalisht nga dispozita penale e posaçme dhe kriteri i maksimumit të marzhit të dënimit për secilën vepër përbën një baraspeshim të drejtë midis interesit

⁹⁸ Nr. *** prot., datë 2.7.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁹ Me pyetësorin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁰ I cili parashikon: “Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit (hequr fjalë dhe ndryshuar fjalë në shkronjën “c” të pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) 1. Procedimi penal nuk mund të fillojë kur: ...d) vepra penale është shuar;...”

publik për ndjekjen dhe ndëshkimin e veprës penale dhe ato të individit për lirinë dhe sigurinë juridike. Subjekti ka argumentuar se nga përmbajtja e nenit 66 të Kodit Penal rezulton se afati i parashkrimit llogaritet në ditë kalendarike, sipas rregullave të përgjithshme. Afati fillon në çastin kur vepra konsiderohet e kryer dhe përfundon ditën e fundit korresponduese të plotësimit të tij. Si pikë referimi merren çasti i kryerjes së veprës dhe çasti i marrjes së personit si i pandehur. Pra, kërkesë e detyrueshme e ekzistencës së parashkrimit është plotësimi i afateve të tij në momentin e marrjes së personit si i pandehur. Bazuar në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore rezulton se për veprat penale të qëndrueshme afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të ecë nga çasti i zhdukjes së gjendjes kriminale, ndërsa në veprat penale vazhduese afati i parashkrimit fillon nga momenti i kryerjes së veprimit të fundit kriminal të saj. Ndërsa neni 291/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Vendimi për mosfillimin e procedimit (shtuar pikat 3, 4, 5 dhe fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017; shtuar pika 2/1, ndryshuar pikat 3 dhe 5 me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021) 1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”*.

41.8 Subjekti ka sqaruar se ky është rasti kur procedimi penal nuk mund të fillojë. Subjekti ka deklaruar se Gjykata e Apelit ka urdhëruar kthimin e akteve dhe fillimin e hetimeve, por nuk mund të bëhen hetime jashtë një procedimi penal, pasi dispozita e mësipërme nuk lejon fillimin e procedimit. Sipas mendimit të subjektit, të dyja dispozitat e mësipërme nuk lënë vend as për interpretim, pasi janë shumë të qarta ndalimet e një hetimi (procedimi).

41.9 Subjekti ka theksuar se: *“Përveç kësaj, siç kam shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, aktualisht çështja gjyqësore që i përket vendimit nr. *** akti, datë 28.6.2019, është në Gjykatën e Lartë, me status “Studim çështjeje” dhe është ajo gjykatë që do të vendosë përfundimisht cila gjykatë ka të drejtë”*.

41.10 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit në raport me ligjin e zbatueshëm, referuar gjithashtu dokumentacionit të administruar, konkretisht vendimeve gjyqësore, por edhe statusit aktual të çështjes, çmon se për sa kohë çështja vijon të jetë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë dhe në raport edhe me bindjen e brendshme të argumentuar ligjërish nga subjekti për vendimmarrjen e tij, nuk arrin të identifikojë fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

42. Denoncim¹⁰¹ i shtetases L.B

42.1 Denoncuesja ankohet paralelisht për një subjekt rivlerësimi me funksion prokuror, por edhe për subjektin, objekt i këtij hetimi administrativ, për shkak se çështja ka nisur në organin e akuzës bazuar në kallëzimin e saj për përdorim të dokumenteve të falsifikuara me pasoja në një çështje pronësore, për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe, më tej, nga subjekti i rivlerësimit nuk është pranuar ankimi i bërë ndaj vendimit të organit të akuzës. Denoncuesja nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës.

42.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte në lidhje me këtë denoncim, si dhe të qartësonte e dokumentonte statusin ligjor të kësaj çështjeje deri aktualisht.

42.3 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar në prapësime mbi thelbin e çështjes, e cila i referohet mosmarrëveshjes së palëve për mosdorëzimin e një pjese të pasurive të ndërtuara nga ndërtuesi ndaj kallëzimitarëve, pasi një pjesë ua ka dorëzuar. Subjekti ka theksuar se mosmarrëveshja është juridiko-civile dhe jo penale. Ai ka konkretizuar se në rastin në fjalë kallëzimitarët bëhet fjalë për një akt ekspertimi të paraqitur në gjykatë, i cili është kryer me dokumente fotokopje dhe jo me origjinal. Është

¹⁰¹ Nr. *** prot., datë 29.7.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

fakt i njohur shkencërisht, ka theksuar subjekti, që ekzaminimi kryhet me dokumentet origjinale. Ai ka konfirmuar se kallëzimet kanë ngritur padi civile në gjykatë, e cila është rrëzuar nga gjykata. Subjekti ka deklaruar se në gjykimin e zhvilluar prej tij ata parashtruan se nuk e kanë ngritur pretendimin në gjykatën civile. Subjekti ka theksuar se *goditja për falsitet kryhet në gjykimin civil sipas parashikimeve të neneve 270-280 të Kodit të Procedurës Civile dhe se kemi të bëjmë me një provë që i është nënshtruar një procesi gjyqësor dhe nuk është deklaruar e falsifikuar*. Në lidhje me statusin e çështjes, subjekti ka konfirmuar se çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe nuk është gjykuar ende. Subjekti ka depozituar vendimin e gjykatës dhe shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, të kryesekretares së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

42.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, por edhe referuar statusit aktual të çështjes, çmon se për sa kohë çështja vijon të jetë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë, nuk mund të konkludojë për fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

43. Denoncim¹⁰² i banorëve të fshatit M., përfaqësuar nga kryetari A.A

43.1 Denoncuesit ankohen për disa subjekte rivlerësimi, me pretendimin se nuk kanë zgjidhur drejt çështjen e tyre pronësore për uzurpimin e një toke në fshat për shkak të përdorimit të dokumenteve false. Denoncuesit nuk kanë depozituar ndonjë të dhënë apo dokumentacion që identifikon subjektin e rivlerësimit.

43.2 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

44. Denoncim¹⁰³ i shtetasit V.Ç

44.1 Denoncuesi ankohet për shumë subjekte rivlerësimi, ndërsa nuk prezanton ankesë konkrete ndaj subjektit, objekt i këtij hetimi administrativ.

44.2 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

45. Denoncim¹⁰⁴ i shtetases V.T

45.1 Denoncuesja ankohet për disa subjekte rivlerësimi në kuadër të zgjedhjes që ata bëjnë për avokatët mbrojtës kryesisht, të marrë për të akuzuarit. Denoncuesja kërkon që ankesa e saj të shërbejë edhe për një kallëzim penal ndaj tyre. Ajo pretendon se kolegë të saj janë të preferuar të subjekteve.

45.2 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

46. Denoncim¹⁰⁵ i shtetasit RR.L

Denoncuesi në ankimin e tij nuk prezanton asnjë të dhënë apo shkelje në adresë të subjektit të rivlerësimit.

47. Denoncim¹⁰⁶ i shtetasit E.D

¹⁰² Nr. *** prot., datë 7.12.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰³ Nr. *** prot., datë 14.6.2018 dhe nr. 8 prot., datë 6.1.2020 (përcjellë nga Kolegji), administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁴ Nr. *** prot., datë 14.6.2018, administruar në dosjen e Komisionit. Në këtë numër protokollit është regjistruar ky denoncim i përcjellë nga Kolegji me nr. ***, datë 8.6.2018.

¹⁰⁵ Nr.*** prot., datë 14.6.2018, administruar në dosjen e Komisionit. Në këtë numër protokollit është regjistruar ky denoncim i përcjellë nga Kolegji.

¹⁰⁶ Nr. *** prot., datë 16.6.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

47.1 Denoncuesi pretendon për zvarritje të procesit gjyqësor të vënë në lëvizje prej tij me kërkesën e datës 23.3.2021, me objekt “Për dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal. Denoncuesi pretendon se nuk është njoftuar as ai dhe as avokatja e tij për rreth 2 muaj. Pasi parashtron problematika në lidhje me mosmarrëveshjet e ndodhura në vijim midis tij, gjykatës dhe avokatit mbrojtës, pretendon se më tej kërkesa është lënë pa veprime për 4 muaj. Pretendon se njëkohësisht ka kërkuar edhe përjashtimin e subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni shoqërues rezulton se në datën 9.6.2021 është kërkuar përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes.

47.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit¹⁰⁷ që për çështjen që i përket kërkesës penale të shtetasit E.D (përfaqësuar nga av. V.T), datë 23.3.2021, “Për dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, të japë shpjegime në lidhje me: (a) kohëzgjatjen e shqyrtimit të kërkesës; (b) njoftimet e bëra palëve për datën e gjykimit; (c) informacionin që Komisioni disponon aktualisht, se kërkesa është lënë pa veprime për 4 muaj; (ç) kërkesën datë 9.6.2021, të shtetasit D, me të cilën është kërkuar përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes; (dh) faktin nëse çështja ka përfunduar dhe nëse ndaj saj është ushtruar ankim, duke sqaruar në këtë rast edhe statusin e saj deri aktualisht.

47.3 Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitojë dokumentacionin justifikues (kopje të fletëthirrjeve, procesverbaleve për mbajtjen e seancave, vendime të ndërmjetme, vendimin përfundimtar, vërtetime, etj.).

47.4 Subjekti, në lidhje me kërkesën penale me nr. *** akti, datë regjistrimi 24.3.2021, ka sqaruar se *kërkesa për gjykim është regjistruar në datën 24.3.2021 dhe ka përfunduar në datën 9.6.2021, pra nuk është lënë pa veprime.* Subjekti ka qartësuar se *seanca e parë pajtimore është caktuar në datën 5.5.2021, seancat vijuese janë caktuar në datën 24.5.2021, ora 10:00, dhe në datën 9.6.2021, ora 10:00.* Gjithashtu, ai ka sqaruar *arsyet e shtyrjes së seancave, të cilat kryesisht kanë qenë si rrjedhojë e mungesës së gjeneraliteteve të plota dhe adresave të sakta të të akuzuarve dhe, për pasojë, gjykata e ka konsideruar kërkesën e pavlefshme, duke vendosur pushimin e saj.* Subjekti ka shpjeguar lidhur edhe me rikërkesën penale të paraqitur me nr. *** akti, datë regjistrimi 14.6.2021, me të njëjtat palë dhe objekt kërkimi, kërkesë e cila është regjistruar në datën 14.6.2021 dhe ka përfunduar në datën 25.11.2021. Edhe në këtë rast subjekti ka sqaruar se *ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të mungesës së adresave të sakta të palëve, viktimës dhe të të akuzuarve, si dhe për shkak të mosparaqitjes së viktimës akuzuese e cila ka pasur dijeni për seancën.* Ndërkohë, subjekti ka konfirmuar se *shtyrjet e seancave kanë ardhur edhe si rezultat i diagnostikimit të tij me Covid-19, për shkak se në një periudhë i ka takuar edhe kryerja e pushimeve vjetore, si dhe për shkak të ngarkesës së punës.* Caktimi dhe shtyrja e seancave është konfirmuar nga subjekti, përkatësisht seanca e parë pajtimore është caktuar në datën 14.7.2021, e cila është shtyrë sërish në datën 7.9.2021. Sipas subjektit, *ai ka urdhëruar komisaritet e policisë për gjetjen dhe njoftimin e palëve, të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme.* Për shkak të mosparaqitjes së palëve, subjekti ka vendosur “Pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. *** akti, datë regjistrimi 14.6.2021”, të viktimës akuzuese E.D, i akuzuar V.H, për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, për shkak se viktimë akuzuese nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, pasi ka pasur dijeni në disa seanca dhe nuk është gjetur në adresën e deklaruar nga ana e tij. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë në datën 21.1.2022, pa u ankimuar. Viktimë akuzuese është njoftuar nga kryesekretaria me shpallje publike. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se ai ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e subjektit, ky i fundit është shprehur se në dijeninë e tij nuk rezulton që shtetasi D të ketë kërkuar përjashtimin e tij dhe se nuk i është komunikuar ndonjë kërkesë për përjashtim. Subjekti ka depozituar kopje të dosjeve përkatëse. Nga verifikimi i akteve në dosje, Komisionit i rezultoi se veprimet gjyqësore janë pasqyruar nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve përkatëse dhe vendimeve të

¹⁰⁷ Me pyetësin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

ndërmjetme. Po ashtu, rezulton se vendimi i pushimit të kësaj çështjeje ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar.

47.5 Në vijim të shqyrtimit të akteve të administruara, Komisioni, nga verifikimi i tyre, në raport me pretendimet e denoncuesit dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, konstatoi se: (i) seancat që i përkasin gjykimit të kërkesës penale nr. ***, datë 24.3.2021, janë caktuar në tejkalim të afatit 15-ditor; (ii) dukej se subjekti, po në këtë çështje, nuk kishte kryer veprime procedurale për njoftimin e palëve përmes komisariateve të policisë, sikurse kishte vepruar në gjykimin e kërkesës së përsëritur.

47.6 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe të depozitonte çdo dokumentacion të vlerësuar për të provuar të kundërtën e konstatimit.

47.7 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar në prapësime se seancat e shtyra tej afatit 15-ditor janë shtyrë për shkaqe të ndryshme, të sqaruara edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 4. Subjekti ka shpjeguar lidhur me shtyrjen e seancave për gjykimin e kërkesës me nr. *** akti, datë regjistrimi 24.3.2021, për të cilat ka konkretizuar se ato janë shtyrë kryesisht për t'i dhënë mundësi viktimës akuzuese të plotësonte të metat e kërkesës, konkretisht plotësimin e gjeneraliteteve të të akuzuarve dhe, në mënyrë të theksuar, adresën e saktë të tyre, në mënyrë që të bëhej njoftimi. Subjekti ka cituar se: *“Gjykata e ka toleruar viktimën akuzuese, duke shtyrë seancat për plotësim gjeneralitetesh, pasi siç e kam shpjeguar edhe në pyetësorin nr. 4, gjykata mund ta deklaronte menjëherë të papranueshëm kërkesën për gjykim, bazuar në nenin 60/1/b të Kodit të Procedurës Penale “Kërkesa e viktimës akuzuese”¹⁰⁸”*. Subjekti ka deklaruar se në këtë rast kërkesa për gjykim e bërë nga viktimja akuzuese E.D është e pavlefshme, pasi nuk përmban gjeneralitetet e personit që akuzohet dhe adresën e tij të saktë. Në lidhje me moskryerjen e veprimeve procedurale për njoftimin e palëve përmes komisariateve të policisë, sikurse është konstatuar nga Komisioni për gjykimin e kërkesës së përsëritur, subjekti ka sqaruar se në rastin konkret ka bërë njoftime me polici gjyqësore, pasi e ka vlerësuar si të saktë adresën e viktimës akuzuese të dhënë nga ana e tij, duke pasur dyshime në lidhje me shënimin e shërbimit postar për adresë të pasaktë të tij në fletëthirrje. Subjekti ka shpjeguar se sipas fletëthirrjes ka rezultuar që adresa të ishte e pasaktë dhe për këtë ka cituar edhe informacionet e përcjella nga Komisioni i Policisë nr. ***, me shkresën nr. *** prot., datë 9.11.2021, me të cilën gjykata u bë me dije se kishin shkuar disa herë në këtë banesë, të cilën ky shtetas rezultonte ta kishte dhënë me qira. Subjekti ka qartësuar gjithashtu se ishte tentuar edhe komunikimi me telefon dhe nuk ishte arritur dhe se vetë viktimja duhet të kishte njoftuar ndryshimin e adresës së tij. Subjekti ka rikonfirmuar dokumentacionin e depozituar me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, i cili është cituar më sipër.

47.8 Trupi gjykues i çmon bindëse shpjegimet e subjektit dhe në raport me veprimet e duhura procedurale të kryera lidhur me njoftimin e palëve në proces, të cilat rezultuan konform legjislacionit në fuqi, nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

48. Denoncim¹⁰⁹ i shtetasit M.K

Denoncuesi në ankimin e tij nuk prezanton asnjë të dhënë apo shkelje në adresë të subjektit të rivlerësimit.

49. Denoncim¹¹⁰ i shtetasës T.D

49.1 Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim të padrejtë, duke qenë se ka lënë në fuqi vendimin e prokurorit për “Mosfillimin e procedimit penal”, duke sjellë si pasojë humbjen e

¹⁰⁸ “1. Kërkesa për gjykim e viktimës akuzuese depozitohet në sekretarinë e gjykatës. Ajo është e pavlefshme në qoftë se nuk përmban: a) gjeneralitetet e viktimës akuzuese dhe adresën e saktë të saj; b) gjeneralitetet e personit që akuzohet dhe adresën e tij;..”.

¹⁰⁹ Nr. *** prot., datë 29.10.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁰ Nr. *** prot., datë 25.4.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

pronës. Ndërkohë, nuk rezulton të jetë bashkëngjitur ndonjë provë apo e dhënë referuese për të provuar këtë pretendim.

49.2 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

50. Denoncim¹¹¹ i shtetasit S.S

50.1 Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit se ai shpërdoron detyrën, duke sjellë pasoja të rënda ndaj tij dhe se këtë e mundëson në bashkëpunim me persona të tjerë si prokurorë e gjyqtarë, duke sqaruar se ata kanë marrë vendime ndaj tij mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara. Denoncuesi ka depozituar disa kërkesa, me të cilat i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhomës Penale) ku, ndër të tjera, i kërkon të njihet me kopje të dosjes, por në asnjë rast nuk identifikohet që ankohet ndaj vendimmarrjes/ve të subjektit të rivlerësimit dhe as nuk citon të tilla. Më konkretisht, nga dokumentacioni bashkëshoqërues i denoncimit vërehet se në datën 18.10.2018 shtetasi S.S i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhomës Penale) me disa kërkesa ku, ndër të tjera, ka kërkuar edhe njohjen me aktet e dosjes penale nr. *** akti. Lidhur me këtë çështje, rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2019, subjekti i ka kthyer përgjigje përfaqësuesit të shtetasit S, z. K.I (për çështjen me nr. *** akti, datë 18.10.2018) ku, ndër të tjera, e njofton se i vendos në dispozicion vendim-kalimi, njoftimet, shkresat dhe kërkesat e bëra prej shtetasit S, gjithsej 72 faqe, si dhe një kopje të CD-së së seancave gjyqësore, datë 27.9.2018, 2.10.2018 dhe 8.10.2018.

50.2 Komisioni i ka kërkuar subjektin¹¹² të depozitojë të njëjtin dokumentacion të cilin citon në kthimin e përgjigjes denoncuesit, së bashku me CD-në që gjithashtu referohet në kthimin e përgjigjes.

50.3 Subjekti depozitoi kopjen e dosjes gjyqësore, nga ku konstatohet se konfirmohet dhënia e dokumentacionit përmes avokatit si përfaqësues i denoncuesit/i pandehur.

50.4 Në këto rrethana, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

51. Denoncim i “Raiffeisen Bank” sh.a, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. CH.C

51.1 Denoncimi ka parashtruar pretendime lidhur me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në çështjen gjyqësore penale, me kërkues Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur shtetasin E.GJ, me detyrë përmbarues, i akuzuar për kryerje të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me objekt “Dërgimin e çështjes për gjykim ndaj këtij të pandehuri”. Çështja penale i referohet kallëzimit të shtetasit D.B, si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k./***, ndaj shoqërisë përmbarimore “***” sh.p.k., me përmbarues shtetasin Gj., akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, si dhe ndaj personit A.Z, për veprën penale “shpërdorim i kompetencave”. Shoqëria “***” sh.p.k. dhe banka duket se kanë pasur bashkëveprim të ndërsjellë në marrjen e disa kredive dhe se më tej kanë kaluar në problematika në shlyerjen e tyre. Duket se si pasojë e moszgjidhjes së tyre shtetasi B. ka kallëzuar në organin e akuzës përmbaruesin gjyqësor dhe zv/drejtorin e bankës. Organi i akuzës ka dërguar në gjykatë kërkesën për gjykim ndaj shtetasit Gj., me detyrë përmbarues gjyqësor, për veprën penale “shpërdorim detyre”, ndërsa nuk është shprehur lidhur me të kallëzuarin tjetër, shtetasin Z. Denoncuesi ankohet se vendimmarrja është e padrejtë, është dhënë në tejkallim të kompetencave, duke iu referuar këtu neneve 329 dhe 329/b të Kodit të Procedurës Penale dhe se krijon precedent, për sa kohë gjykata/subjekti i rivlerësimit, përveçse ka dërguar për gjykim shtetasin Gj, me detyrë përmbarues, sikurse ishte kërkuar edhe nga organi i akuzës, ka kthyer aktet për

¹¹¹ Nr. *** prot., datë 17.1.2019, nr. *** prot., datë 18.3.2019, nr. *** prot., datë 22.10.2018, nr. *** prot, datë 29.10.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹² Me pyetësin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

të formuluar akuzë ndaj shoqërisë përmbarimore dhe shtetasit Z, me detyrë *** i bankës, megjithëse organi i akuzës nuk kishte paraqitur kërkesë në gjykatë për këtë të fundit dhe se emri i tij nuk ishte regjistruar sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale.

51.2 Nga ana tjetër, nga leximi i arsytimit të vendimit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit e ka quajtur gjithashtu të paprecedentë situatën për sa i përket anës formale të paraqitjes së kërkesës së organit të akuzës për dërgimin në gjyq pjesërisht të çështjes së procedimit penal të bashkuar, ndërsa për pjesën tjetër nuk ka asnjë kërkesë të saj, në kundërshtim me detyrimin që ka prokuroria në zbatim të nenit 327/6/a/b të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me kallëzimin e shtetasit B. ndaj këtyre të kallëzuarve.

51.3 Komisioni i kërkoi subjektit¹¹³ të qartësojë dhe të dokumentojë deri aktualisht statusin e vendimit të dhënë prej tij, me datë 21.11.2019 (që i përket çështjes penale me nr. *** akti, datë regj. 20.9.2019), me të pandehur shtetasin E.GJ. Më konkretisht, kërkimi i Komisionit i përket veçimit të çështjes, kthimin e akteve dhe formulimin e akuzës nga organi i akuzës, shprehur në dispozitivin e vendimit, për të cilin lejohet e drejta e ushtrimit të ankimit.

51.4 Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin rezulton se është lënë në fuqi vendimi nr. *** akti, datë 21.11.2019, i subjektit, për sa i përket të pandehurit E.GJ, ndërsa është prishur pjesa tjetër e lidhur me veçimin e çështjes dhe dërgimin pranë organit të akuzës për të formuluar akuzën ndaj shoqërisë përmbarimore dhe shtetasit Z, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm i bankës.

51.5 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte, pasi dukej se: (i) kishte vepruar në kundërshtim me nenin 329/4¹¹⁴ të Kodit të Procedurës Penale; por edhe për shkak se (ii) nga gjykata më e lartë ishte konstatuar se ndjekja penale për çështjen e veçuar me qëllimin kthimin e saj për të formuluar akuzën ishte parashkuar, fakt i cili nuk rezultonte i konsideruar në vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

51.6 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar në prapësime se nga ana e prokurorisë, me vendimin “Mbi bashkimin e procedimeve”, datë 11.2.2019, është vendosur “Bashkimi i procedimit të çështjeve nr. *** të vitit 2015 dhe nr. *** të vitit 2017, duke i numërtuar me nr. *** të vitit 2015”. Këto dy çështje ishin kthyer në prokurori për plotësim hetimesh nga ana e gjykatës, sipas vendimeve të sipërcituara. Subjekti ka shpjeguar se fillimisht ai ka kthyer për plotësim hetimesh¹¹⁵ procedimin penal nr. *** të vitit 2015, që mbante këtë numër para se të bashkohej dhe që kishte të bënte me kallëzimin e shtetasit D.B ndaj të kallëzuarit A.Z, si dhe ndaj shoqërisë përmbarimore “****” sh.p.k., duke theksuar edhe detyrën e shtuar nga Gjykata e Apelit në lidhje me hetimin e kësaj shoqërie përmbarimore dhe z. A.Z, ku citohej se: “...përveç detyrave që ka lënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të kryejë hetime të plota dhe të konkludojë nëse nga ana e të kallëzuarit A.Z kemi konsumim të veprës penale “shpërdorim i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, pasi kallëzimi jep të dhëna të mjaftueshme për të hetuar në lidhje me këtë vepër penale...”. Subjekti ka sqaruar se në lidhje me këtë procedim penal, pas bashkimit të procedimeve janë kryer disa veprime hetimore, të cilat gjithashtu i ka cilësuar. Subjekti ka pasqyruar edhe konkludimin e organit të akuzës në lidhje me këtë çështje, ku citohej se: “Nga hetimet e kryera ka rezultuar se nga ana e shtetasit A.Z, në cilësinë e zv/drejtorit të “Raiffeisen Bank”, nuk janë konsumuar elemente të ndonjë vepre penale, pavarësisht pretendimeve të kallëzuesit. Veprimet e kryera prej tij (vënia në ekzekutim të menjëhershëm e titujve ekzekutivë, pa përfunduar procesi i ristrukturimit

¹¹³ Me pyetësin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁴ Sipas nenit 329/4 të Kodit të Procedurës Penale: “Gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorin që të formulojë akuzë për persona të tjerë, emri i të cilëve nuk është regjistruar sipas nenit 287 të këtij Kodi. Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime, edhe në rastet kur vendos sipas shkronjës “c”, të paragrafit 3 të këtij neni.”

¹¹⁵ Me vendimin nr.***, datë 15.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 4.4.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

të kredisë) i kanë shkaktuar atij dëm ekonomik nga pikëpamja civile, për shqyrtimin e të cilit nuk është kompetent organi procedues. Megjithatë, ky fakt nuk i heq të drejtën kallëzuesit që pretendimet e tij t'i paraqesë në Gjykatën Civile. Është pikërisht kjo gjykatë e cila nga pikëpamja materiale do të vlerësojë masën e dëmit të shkaktuar kësaj shoqërie.” Subjekti ka argumentuar se prokuroria nuk ka zbatuar nenin 327/6/a/b të Kodit të Procedurës Penale¹¹⁶, pasi nuk ka ardhur në gjykatë në përfundim të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. *** të vitit 2015, që mbante këtë numër para se të bashkohej dhe që ka të bëjë me kallëzimin e shtetasit D.B ndaj të kallëzuarit A.Z, si dhe ndaj shoqërisë përmbarimore “****” sh.p.k., e cila është kthyer për plotësim hetimesh me vendimin nr. ***, datë 15.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 4.4.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës ose të çështjes, ose dërgimin e çështjes në gjyq. Subjekti ka theksuar se në rastin konkret gjykata është ndodhur përpara një situatë të paprecedentë, për sa i përket anës formale të paraqitjes së kërkesës së prokurorisë për dërgimin në gjyq pjesërisht të çështjes së procedimit penal të bashkuar, ndërsa për pjesën tjetër të këtij procedimi nuk ka asnjë kërkesë të saj, në kundërshtim me detyrimin që ka prokuroria në zbatim të nenit 327/6/a/b të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me kallëzimin e shtetasit A.B ndaj të kallëzuarve A.Z dhe shoqërisë përmbarimore “****” sh.p.k. Subjekti ka ritheksuar gjithashtu se emri të cilit i atribuohet vepra penale i të kallëzuarve A.Z ishte regjistruar me urdhërimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 4.4.2018, kishte lënë si detyrë në lidhje me hetimin e shoqërisë përmbarimore “****” dhe z. A.Z që të kryheshin hetime të plota dhe të konkludohej nëse nga ana e të kallëzuarit A.Z kishte konsumim të veprës penale “shpërdorim i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, pasi kallëzimi jepte të dhëna të mjaftueshme për të hetuar në lidhje me këtë vepër penale...”.

51.7 Në lidhje me konstatimin e Gjykatës së Apelit se ndjekja penale për këtë shtetas është parashkruar, subjekti ka sqaruar se kjo gjykatë ka gabuar në përcaktimin si datë të fundit të kryerjes së elementeve të veprës penale, dhjetor 2014. Subjekti ka shpjeguar se ky përcaktim është i pasaktë sepse në vendimin e tij është argumentuar si datë fundore e kryerjes së krimit “shpërdorim i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, data 19.1.2016, ku është paraqitur si provë shkresore korrespondenca me palë shoqërinë përmbarimore “****” sh.p.k. (nr. *** prot., datë 19.1.2016 dhe nr. *** prot., datë 14.1.2016, ku është kërkuar nga z. A.Z vazhdimi i procedurave përmbarimore të pezulluara nga ana e përmbaruesit për klientin ***/“****” sh.p.k., në kundërshtim me ligjin. Subjekti ka theksuar se nga data 19.1.2016 deri në datën 21.11.2019, kur është shpallur vendimi në shkallë të parë, nuk kanë kaluar 5 vjet. Njëkohësisht, subjekti ka theksuar se edhe duke iu referuar periudhës dhjetor 2014, së cilës i është referuar Gjykata e Apelit për të llogaritur afatin e parashkrimit, përsëri deri në datën e shpalljes së vendimit në shkallë të parë, 21.11.2019, nuk rezulton të jetë plotësuar afati 5-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale.

51.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit në raport me vendimet gjyqësore të administruara dhe ligjin e zbatueshëm, nuk konstaton problematika në lidhje me zbatimin e neneve 327/6/a/b dhe 329/4 të Kodit të Procedurës Penale. Në analizë të dokumentacionit, trupi gjykues konstatoi se emrat e personave të akuzuar ishin të regjistruar në procedim penal dhe, në këto kushte, çmuarja e korrektësisë së vendimmarrjes është kompetencë e gjykatës. Gjithashtu, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit edhe lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është konstatuar se ndjekja penale për këtë shtetas është parashkruar, përpos edhe faktit që më parë e njëjta gjykatë ishte shprehur dhe kishte shtuar detyrat e lëna për t’u kryer nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë, duke cituar: “...përveç detyrave që ka lënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të kryejë hetime të plota dhe të konkludojë nëse nga ana e të kallëzuarit A.Z kemi konsumim të veprës penale “shpërdorim i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, pasi kallëzimi jep të

¹¹⁶ I cili parashikon: “6. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë: a) vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i Kodit; b) i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi.”

dhëna të mjaftueshme për të hetuar në lidhje me këtë veprë penale... ”. Në të tilla kushte, nga shqyrtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues nuk konstaton fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

52. Denoncim¹¹⁷ i shtetasit A.R

52.1 Denoncuesi prezanton një ankesë të përgjithshme në drejtim të prokurorit dhe subjektit të rivlerësimit pa prezantuar rrethanat e çështjes. Kryesisht pretendimet parashtrihen drejtuar prokurorit, por edhe gjykatës/subjektit të rivlerësimit për moscaktimin e dy ekspertëve/mjek ortoped të spitalit të traumës për shkak të qenies së tyre në konflikt interesi. Duket se çështja i referohet një aksidenti të ndodhur me motoçikletë, ku ka pësuar dëmtime të rënda djali i denoncuesit, i cili më tej, për shkak të mangësive të konstatuara gjatë trajtimit mjekësor, ka pësuar dëmtim të rëndë të shëndetit. Për këtë çështje duket se është marrë në akuzë i pandehuri GJ.Ç (shefi i ***), për “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, si mjeku që ka trajtuar të sëmurin. Për shkak se ekspertët janë në varësi të tij në pozicionin e punës që kryejnë, denoncuesi ka kërkuar largimin e tyre (me kërkesën¹¹⁸ e datës 17.5.2016, depozituar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 18.6.2016) nga kryerja e aktit të ekspertimit, duke i trajtuar ata në konflikt interesi. Akti i ekspertimit është kërkuar nga gjykata të kryhet për të konkluduar mbi dëmtimet e ardhura si pasojë e mangësive të vërejtura përgjatë trajtimit mjekësor. Nga dokumentacioni shoqërues i denoncimit dhe sqarimet e denoncuesit vërehet se gjykata, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2017 (të subjektit të rivlerësimit), ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit GJ.Ç, akuzuar veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal.

52.2 Komisioni i kërkoi subjektit¹¹⁹ të qartësojë dhe të dokumentojë deri aktualisht statusin e çështjes penale të gjykuar dhe përfunduar nga ana e tij, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2017, me të cilin është vendosur “Deklarimi i pafajshëm i të pandehurit GJ.Ç”, akuzuar për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal.

52.3 Subjekti ka qartësuar se çështja është ankimuar dhe se aktualisht administrohet në Gjykatën e Apelit Tiranë. Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 8.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 14.4.2023, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin provohet ushtrimi i ankimit.

52.4 Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte lidhur me pretendimet e denoncuesit se ata kanë kërkuar me kërkesën¹²⁰ e datës 17.5.2016, depozituar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 18.6.2016, largimin e ekspertëve që ishin në varësi të të pandehurit në pozicionin e punës që ai kryente. Komisioni i kërkoi subjektit të dokumentonte trajtimin e kësaj kërkesë.

52.5 Subjekti, në prapësime, thekson se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit. Subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer aktin e ekspertimit me ekspertë të cilët kanë qenë kundërshtuar nga denoncuesi por, përkundrazi, është caktuar një grup ekspertësh, në mes të të cilëve nuk janë përzgjedhur të kundërshtuarit. Ai ka shpjeguar në detaje historikun e kësaj çështjeje lidhur me caktimin e ekspertëve, mënyrën e përzgjedhjes së tyre, me vendimin e ndërmjetëm datë 7.11.2016, pasi i është vënë në dispozicion të gjykatës shkresa nr. *** prot., datë 7.11.2016, nga Presidenti i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, dr. F.B (bashkëlidhur lista prej 48 mjekësh të specializuar në fushën e ortopedisë, pas disa përjashtimeve për shkaqe objektive dhe ligjore, duke caktuar edhe detyrat që do të kryenin). Subjekti ka përshkruar veprimet e kryera në seancën gjyqësore të datës 29.3.2017, ku është paraqitur akti i riekspertimit të bërë nga tre mjekët: prof. dr. P.B, prof. dr. P.K, prof. dr. I.M (gjithsej 34

¹¹⁷ Nr. *** prot., datë 22.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 30.3.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁸ Administruar në dokumentacionin shoqërues të denoncimit.

¹¹⁹ Me pyetësin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²⁰ Administruar në dokumentacionin shoqërues të denoncimit.

fletë), ku në përfundim i përgjigjen detyrave të lëna nga gjykata. Subjekti ka shpjeguar se së bashku me këtë akt, nga ana e gjykatës është bërë pjesë e fashikullit të gjykatës edhe mendimi i dy ekspertëve të IML-së, të caktuar nga gjykata në përbërje të grupit të ekspertëve në seancat e mëparshme, mjekët Z. I dhe A.S, dhe se faktet e mësipërme janë të pasqyruara edhe në vendimin e gjykatës. Subjekti ka depozituar vendimin e gjykatës.

52.6 Trupi gjykues, pasi verifikoi vendimin gjyqësor, vëren se ai është i mirargumentuar dhe se në të janë përshkruar në detaje të gjithë veprimet procedurale të kryera për përzgjedhjen e ekspertëve, si dhe detajet e aktit të ekspertimit për çështjen objekt gjykimi. Në të tilla kushte, duket se nuk qëndrojnë pretendimet e denoncuesit, si dhe nuk vërehen fakte apo rrethana që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

53. Denoncim¹²¹ i shtetasve K.Y dhe D.D

53.1 Denoncuesit ankohen për vendimmarrje të padrejtë dhënë nga trupa gjykuese e përbërë edhe nga subjekti i rivlerësimit. Më konkretisht, denoncuesi pretendon se janë dënuar persona të pafajshëm, ndërsa duheshin dënuar të tjerë dhe se kjo vendimmarrje ka ardhur vetëm për shkak të trysnisë së ushtruar nga procesi i *Vetting*-ut, të cilit subjektet i janë nënshtruar.

53.2 Denoncuesit kanë depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 21.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur G.H, D.Y, G.D dhe A.G, akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, me të cilin trupa gjykuese, me kryesues subjektin e rivlerësimit, pas konkluzionit përfundimtar të përfaqësuesit të organit të akuzës, ka vendosur dënimin e secilit shtetas me nga 7 vjet burgim.

53.3 Komisioni i kërkoi subjektit¹²² të qartësojë dhe të dokumentojë deri aktualisht statusin e vendimmarrjes së lartpërmendur.

53.4 Subjekti ka deklaruar se çështja gjyqësore, përfunduar prej tij me vendimin nr. ***, datë 21.9.2018, është në gjykim në Gjykatën e Lartë, me status “Studim çështjeje”. Subjekti ka depozituar vendimet përkatëse të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe printimin nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë.

53.5 Nga verifikimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit rezulton se ai ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke ulur masën e dënimit për të pandehurit H, Y. dhe D. dhe ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin G.

53.6 Për sa më sipër, duket se pretendimet e denoncuesit lidhen me shqyrtimin e themelit të çështjes dhe për sa kohë çështja është ende në proces gjyqësor trupi gjykues nuk mund të konkludojë në problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

54. Denoncim¹²³ i shtetasit H.N

54.1 Denoncuesi ankohet për vendimmarrja të padrejtë, dhënë ndaj djalit të tij F.N, i akuzuar për veprën penale “vjedhje me dhunë” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal.

54.2 Denoncuesi ankohet ndaj një tjetër subjekti rivlerësimi, por në vendimet e depozituara ka bashkëngjitur edhe një vendim të dhënë nga subjekti i rivlerësimit në datën 10.3.2014, ku përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar revokim të vendimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim (pasi ndaj të dënuarit N gjykata në shqyrtimin e themelit të çështjes ka aplikuar edhe nenin 59 të Kodit Penal), të dhënë më parë në vitin 2011 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj shtetasit N, për shkak

¹²¹ Nr. *** prot., datë 1.11.2018 dhe nr.*** prot., datë 9.10.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²² Me pyetësin nr. 4, datë 13.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²³ Nr.*** prot., datë 21.11.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

se pas një kohe që mbante kontakte të rregullta me shërbimin e provës ka munguar në vijim duke iu shmangur takimeve.

54.3 Vendimi i subjektit të rivlerësimit ka pranuar pjesërisht kërkesën e organit të akuzës, duke i shtyrë afatin e mbikëqyrjes të dënuarit për të vijuar e mbajtur kontakte me shërbimin e provës, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar.

54.4 Trupi gjykues, nga shqyrtimi i këtij denoncimi, nuk konstaton ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

55. Denoncim¹²⁴ i shtetasit F.B

55.1 Denoncuesi nuk ka parashtruar përmbajtje të një denoncimi sipas kërkesave të nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, por ka depozituar kallëzimin që i drejton SPAK-ut lidhur me disa individë dhe subjekte rivlerësimi në pozicionin e prokurorit apo gjyqtarit, duke përfshirë këtu edhe subjektin e rivlerësimit. Kallëzuesi ka vënë në lëvizje këtë institucion duke kallëzuar shtetasit, me qëllim nisjen e procedimit penal për veprat penale “falsifikim dokumentesh”, “ekspertim i rremë”, “moskallëzim krimi”, etj. Kallëzuesi, ndërsa parashtron se janë bërë veprime fiktive dhe janë përdorur dokumente të falsifikuara në çështje të hetuara nga prokurorë lidhur me problematika të hasura në ndërtimin e hidrocentralit të Kalivacit, kallëzon edhe gjyqtarë, nën argumentin se nuk kanë referuar pranë organit të prokurorisë aktet e falsifikuara të pretenduara prej denoncuesit se janë përdorur në dosjet hetimore apo gjyqësore.

55.2 Kallëzimi i depozituar në këtë rast është trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, në datën 27.1.2022, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”. Kjo çështje është trajtuar më sipër në këto rezultate hetimi.

55.3 Trupi gjykues, nga shqyrtimi i këtij denoncimi, nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

56. Denoncim i shtetasit B.R (me cilësinë e avokatit mbrojtës të shtetasit K.L)

Denoncimi përmban të njëjtën problematikë, sikurse referohet më sipër në informacionin e përcjellë nga SPAK-u, për të cilin Komisioni hetoi dhe është shprehur më sipër.

57. Denoncim anonim¹²⁵, në të cilin përgjithësisht trajtohet CV-ja e subjektit të rivlerësimit (si e papërshtatshme për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit) dhe nuk prezantohen problematika të rolit dhe punës së tij, sikurse parasheh neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

58. Denoncim i shtetasit R.H¹²⁶

58.1 Nga verifikimi nuk identifikohen shtetas me këto të dhëna. Rezulton se denoncuesi ka dërguar një kopje të shkrimeve në median e shkruar, ku identifikohen disa subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjekti Lazër Sallaku. Për çështjet e pasqyruara në shkrime nuk evidentohen të dhëna konkrete për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit, por jepen të dhëna mbi çështje të gjykuara nga ky subjekt. Nga leximi i Komisionit në median e shkruar, të dhënat pasqyrojnë kryesisht në dy raste gjykimin e themelit të çështjeve dhe vendimmarrjet e subjektit, edhe pse janë ankimuar, janë lënë në fuqi nga gjykata më e lartë¹²⁷.

58.2 Komisioni, në gjendjen që ndodheshin aktet e këtij denoncimi, i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe të dokumentonte lidhur me vendimmarrjet e tij për dhënien e masës së sigurimit personal “detyrim

¹²⁴ Nr. *** prot., datë 15.12.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²⁵ Nr. ***prot., datë 15.2.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²⁶ Përcjellë në datën 28.4.2023.

¹²⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/lobimi-rus-si-e-shpetuan-b-nga-ndeshkimi-berisha-me-gjyqtaret-lazer-sallakun-A.M-dhe-SH.B-nuk-njohen-provat-dhe-deshmine-e-m-ne-shba>

paraqitjeje” në çështjen “****” (cituar në artikullin e shkruar, depozituar në formë denoncimi), në raport me kërkimin e organit të akuzës dhe statusin aktual të vendimeve.

58.3 Subjekti, ndër të tjera, në prapësime ka shpjeguar historikun e regjistrimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 6.1.2020, të procedimit penal nr. ***, pas shpalljes nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të moskompetencës së procedimit penal nr. ***, datë 24.12.2019. Ai ka sqaruar se *më parë kishte pasur procedime penale të bashkuara të regjistruara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, regjistruar për veprat penale “grup i strukturuar kriminal”, “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 287/1, 333/a/1 dhe 334 të Kodit Penal, në ngarkim të personave të paidentifikuar. Subjekti ka shpjeguar se në vijim procedimi penal nr. 204 është regjistruar në datën 24.12.2019, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën përcjellëse nr. ***, datë 20.12.2019, ka kthyer aktet që i përkasin procedimit penal nr. ***, datë 4.7.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i regjistruar në ngarkim të shtetasve E.V, A.V, A.M, K.C, E.L, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “grup i strukturuar kriminal”, “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 287/1, 333/a/1 dhe 334 të Kodit Penal dhe A.Ç, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuar nga nenet 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal. Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është regjistruar në datën 4.7.2018, për veprat penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim, dhe “grup i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 287/2 dhe 333/a të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A.V, E.V, E.L, K.C, A.M, A.Ç, ky i fundit, i hetuar edhe për veprën penale “mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar pas shpalljes nga Prokuroria pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Durrës të moskompetencës lëndore të procedimit penal nr.***, datë 24.6.2018, për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Procedimi është regjistruar mbi materialin referues të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës lidhur me sekuestrimin e një sasive të konsiderueshme vlerash monetare në një automjet që hynte në Shqipëri nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Porti i Durrës. Subjekti ka shpjeguar mbi caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurve, duke cilësuar se në varësi të akuzave ndaj tyre ishte caktuar më parë masa “arrest me burg”. Më tej, subjekti ka sqaruar edhe mbi kërkesat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për dërgimin e çështjeve në gjyq kundër disa prej të pandehurve, duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale të pasqyruar si më sipër, si dhe kërkesën për pushimin e procedimit penal për shtetasin A.Ç, për kryerjen prej tij të veprave penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “grup i strukturuar kriminal” dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 287/1, 333/a/2 dhe 334 të Kodit Penal. Subjekti ka shpjeguar mbi qëndrimin e përfaqësuesve të akuzës të mbajtur në seancë paraprake, të cilët, në zbatim të nenit 332/d, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, meqenëse nuk kishin arritur që të mblidhnin akte dhe prova shtesë për të pandehurit A.V, E.V, E.L (E.C), K.C dhe A.M, për akuzat e mëparshme që kishin ngritur në drejtim të tyre, kishin konkluduar që ata duhet të akuzoheshin për kryerjen e veprës penale “Mosdeklarim në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 179/a e 25 të Kodit Penal dhe në këtë rast gjykata, në zbatim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, vendimit njëses të Gjykatës së Lartë nr. 13, datë 4.4.2018, si dhe nenit 332/dh të Kodit të Procedurës Penale, ka çmuar se i vetmi vendim që mund të merrte gjyqtari i seancës paraprake në këtë rast ishte kthimi i akteve në organin e prokurorisë. Subjekti*

ka sqaruar edhe mbi vendimarrjen e gjyqtarit të seancës paraprake ndaj të pandehurit A.Ç. Subjekti ka sqaruar mbi vlerësimet e organit të akuzës për caktimin e masave të sigurimit personal për të pandehurit e këtij procedimi të cilat kishin ndryshuar, referuar momenteve të para të caktimit të masës së sigurimit personal. Subjekti ka shpjeguar se akuzat janë ndryshuar nga gjyqtari i seancës paraprake, e më tej nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nga “grupi i strukturuar kriminal”, “pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 287/1, 333/a/1 dhe 334 të Kodit Penal, në akuzën e “mosdeklarimit në kufi të të hollave dhe sendeve me vlerë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 179/a e 25 të Kodit Penal. Subjekti ka theksuar se më tej prokurorja ka kërkuar ndryshimet e masës së sigurimit personal në “arrest në shtëpi”, si dhe “detyrim për paraqitje”, gjithnjë nën akuzën e ndryshuar për kryerjen e veprës penale “mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë”, të parashikuar nga nenet 179/a/2 e 25 të Kodit Penal. Subjekti ka shpjeguar se gjykata ka mbajtur parasysh faktin se duhet të konkludojë mbi drejtësinë e masës së sigurimit të artikuluar në kërkesë nga prokuroria, përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete, e cila është kundërvajtje penale, për të cilat ligji parashikon një dënim me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet, gjë që paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore. Subjekti ka sqaruar se në zëvendësimin e masës së sigurimit ka pasur parasysh sanksionin e veprës penale dhe prirjen normale dhe natyrore të çdokujt për gëzimin e lirisë personale. Subjekti ka sqaruar se masa më e përshtatshme që arrin të sigurojë nevojat e procedimit penal të nisur për të garantuar mospërsëritjen e së njëjtës veprë penale, si dhe për të garantuar ekzekutimin e dënimit që mund të caktojë gjykata e themelit në rastin konkret, për shkak të rrezikshmërisë së veprës dhe autorëve në rastin konkret, ka qenë “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, por për të dyshuarin A.Ç, i cili ishte i dyshuar edhe për kryerjen e veprës penale “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, dy herë, të parashikuar nga nenet 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal, ka pasur parasysh faktin se ai kishte një kohë të gjatë në paraburgim dhe në total kishte mbi 2 vjet burg, prandaj edhe për këtë shtetas masa e përshtatshme e sigurimit personal ka qenë “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka depozituar vendimin nr. *** regj., datë vendimi 17.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

58.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, në raport me denoncimin e bërë mediatik, në tërësi vërejti se çështjet penale janë vënë në lëvizje nën akuza të rënda, të cilat fillimisht nuk janë hetuar nga juridiksioni i përgjithshëm. Për rrjedhojë, nën këto akuza janë cilësuar dhe vendosur edhe masat e sigurisë. Në vijim, konstatohet se pasi ishte konkluduar nga gjyqtari i seancës paraprake dhe më tej edhe nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, çështja kishte kaluar për gjykim, juridiksionit të përgjithshëm. Kjo, për shkak të ndryshimit dhe rënies së disa akuzave, duke u akuzuar të pandehurit nën akuzën e *Mosdeklarimit në kufi të të hollave dhe sendeve me vlerë*. Trupi gjykues konstatoi se pas këtij ndryshimi, mbi kërkesën e organit të akuzës për të zëvendësuar masat e sigurimit personal, gjykata/subjekti i rivlerësimit ka gjykuar dhe vlerësuar zëvendësimin e tyre. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi nuk vërejti problematika të natyrës procedurale, nuk konkludon në fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të tij.

59. Denoncim¹²⁸ i shtetasit J.V

59.1 Denoncuesi ka përshkruar në tekstin e *email*-it të dhëna nga CV-ja e subjektit të rivlerësimit për të diktuar kryesisht formimin e tij në raport me pozicionin e magjistratit. Përmbajtja e denoncimit nuk

¹²⁸ Nr. *** prot., datë 23.5.2023.

kishte në fokus çështje konkrete apo shkelje konkrete të kryera nga subjekti gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi denoncimi nuk pasqyrore asnjë fakt konkret për t'u shqyrtuar dhe konkluduar.

59.2 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues nuk konkludoi në asnjë fakt apo rrethanë që mund të ndikonte në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Lazër Sallaku:

- a. Në lidhje me kriterin e pasurisë, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimin e pikës 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për këtë kriter, dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- b. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve, vlerëson se ka arritur nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Lazër Sallaku, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka